



# Koha

www.koha.mk



**Karateisti që  
synon piedestalet  
evropiane dhe  
botërore**

EDITORIAL

## Destabilizimi



Qendra amerikane për veprim parandalues nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë, në një raport të hartuar nga ekspertë të politikës së jashtme, paralajmëron se në Ballkan sërish mund të shpërthejë luftë. Rreziqet në Ballkan, sipas amerikanëve, janë trazirat e mundshme politike dhe dhuna ekstremiste në rajon.

RAJON

## Varreza të reja për ushtarët grekë të rënë në Shqipëri

SPECIALE

## KUDSI po përjeton ditët më të vështira



## QEVERIA PO PËRGATIT LIGJ ANTIPOPULLOR

# EDHE PARAT E MËRGIMTARËVE DO TË TATIMOHEN



Ylli Marku, drejtues i "Western Union", agjencisë për transferta të shpejtë të pareve, thotë se me ligjin e ri Qeveria e re ka për qëllim kontrollimin e dërgesave të parave të mërgimtarëve përmes sistemeve financiare legale dhe do të prekë shtresat e varfra, e sidomos shqiptarët që janë dërguesit më të shumtë të parave

## ASH pret të mërkurën të takohen Zaev dhe Sela

Shkup, 17 dhjetor - Plotësimi i vendeve vakante në Qeveri, do të mbetet pezull deri të mërkurën, kur dhe pritet të kthehet nga vizita në SHBA kryetari i Aleancës për shqiptarët Ziadin Sela, përveç nëse dy partnerët tjerë qeveritar, Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë dhe Bashkimi Demokratik për Integrim, mund të marrin vendime të njëanshme para kësaj dite. Kjo, pasi kryeministri Zaev të shtunën, pas

mbledhjes së përbashkët qeveritare me Qeverinë e Shqipërisë në Pogradec, deklaroi se të hënën do të procedojnë emrat për poste qeveritare në Parlament. Siç deklaroi për gazetën KOHA, nënkryetari i ASH-së, Elmi Aziri, vetëm pas takimit Sela - Zaev do të dihet përfundimisht për pozicionin e partisë së tij në Qeveri. Deri të mërkurën kur pritet të kthehet nga vizitat në SHBA kryetari Ziadin Sela...



## EDITORIAL

## DESTABILIZIMI



Shkëlzen HALIMI

Qendra amerikane për veprim parandalues nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë, në një raport të hartuar nga ekspertë të politikës së jashtme, paralajmëron se në Ballkan sërish mund të shpërthejë luftë. Reziqet në Ballkan, sipas amerikanëve, janë trazirat e mundshme politike dhe dhuna ekstremiste në rajon.

Në fakt, Ballkani, për shkak të pozitës gjeostrategjike historikisht ka qenë hapësirë tërheqëse për shtet e fuqishme. Gara për dominimin ekonomik dhe politik të rajonit të Ballkanit është intensifikuar akoma më shumë, në veçanti tani kur për këtë pjesë të rëndësishme të Ballkanit, interesim të veçantë tregojnë Rusia dhe Kina, si dy superfuqi jo vetëm ekonomike, por edhe ushtarake.

Në këtë garë për dominim dukshëm është shtuar edhe aktiviteti diplomatik evropian dhe ai amerikan, që duket se janë në kontakte permanente me liderët e Ballkanit. Në të njëjtën kohë, janë të shumta edhe aktivitetet midis shteteve të Ballkanit, të cilat (pos Serbisë) shpejtojnë që t'i mbyllin disa probleme që zvarriten me vite e vite dhe t'i përkushtohen agjendave ekonomike për t'i dhënë fund jo vetëm krizës ekonomike por edhe tranzicionit pa fund.

Shqiptarët, në kontekstin ballkanik, duket se akoma nuk kanë arritur ta marrin pozicionin që u takon dhe kjo më shumë për fajin e tyre.

Shqiptarët akoma vazhdojnë të merren me vetveten. Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Luginën e Preshevës, lufta për pushtet që moti ka zbehur interesin kombëtar.

Dhe në këtë luftë, të cilën shërbimet e ndryshme e shfrytëzojnë për qëllimet e politikave të tyre, ne vazhdojmë të trajtohem si element destabilizues, i përdorshëm nga të tjerët dhe që interesohet vetëm për përfitime grupore, me aktorë politik që janë mjeshtër për të manipuluar me shtyllat më emocionale të kombit tonë.

Diplomacia paralajmëruese është një segment që bën me dije se duhet pasur kujdes të jashtëzakonshëm për të mos i dhënë shkas palës tjetër që ta ndërrojë rrjedhën e asaj që synohet të arrihet. Aktualiteti në politikën shqiptarë (në gjithë Ballkanin), fatkeqësisht është i zyrtë. Nëse ne harxhojmë energji të jashtëzakonshme, duke u marrë me njëri tjetrin, pala tjetër, pastaj, do ta ketë shumë lehtë që të jetë dy-tri hapa para nesh...



**Shqiptarët, në kontekstin ballkanik, duket se akoma nuk kanë arritur ta marrin pozicionin që u takon dhe kjo më shumë për fajin e tyre. Shqiptarët akoma vazhdojnë të merren me vetveten**

## DY HAPAT E MËDHA TË KOSOVËS

"Kosova bëri dy hapa të mëdhenj drejt ardhmërisë së sigurt në paqe e prosperitet këtë javë. Hapi i parë ishte themelimi i Ekipit Përgatitor që do të përgatisë infrastrukturën teknike e ligjore për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin, si hap përmblyllës i kapitullit të luftës. Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin synon që duke promovuar dialogun në mes të gjitha komuniteteve në Kosovë të arrijë pajtimin për dhimbjet e shkaktuara nga lufta dhe pajtimin që të mos përsëriten më kurrë ato vuajtje dhe shkatërrime. Hapi i dytë ishte arritja e marrëveshjes për projektin "Kosova e Re", që do të nënshkruhet nga palët më 20 dhjetor. Është ky investimi më i madh privat në historinë e Kosovës, prej rreth 1.3 miliardë euro, që do të krijojë 10.000 vende të reja të punës. Mbi të gjitha do të sigurojë pavarësinë energjetike të Kosovës dhe garantojë investimet e tjera në prodhim dhe ekonomi në përgjithësi. Janë hapa historikë që do të forcojnë paqen dhe prosperitetin për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke kontribuar kështu edhe për paqen dhe stabilitetin në rajon e më gjerë. Kur kujtojmë se ku ishim dy dekada më herët, nuk mund të mos mburremi me të arriturat e popullit tonë dhe me përkushtimin për një shtet shembullor", shkruan në profilin e tij në FB kryetari i Kosovës, Hashim Taçi



## KURORË LULESH MBI VARREZAT E DËSHMORËVE NË SHBA

"Çdo vit, dhjetëra mijëra Amerikan, organizohen vullnetarisht, dhe në prag të festave të fundvitit vendosin kurora në varrezat e dëshmorëve. Sot, bashkë me Lendita Haxhitasim, Besianë Musmurati dhe Modesta Imeri nga Ambasada e Kosovës, u bashkuam në këtë aktivitet. Pamë gra e burra, të rritur e fëmijë. Shumë prej tyre kishin udhëtuar me kilometra vetëm për të qenë sot aty. Aty ku pushojnë heronjtë. Jo secili hero sot ka familjarë e të afërm që kanë mundur të udhëtojnë. Por në Arlington sot pati lule e nderim për secilin. Për më pak se tri orë, secili gurë në Arlington (mbi 400.000) u vesh me kurorë lulësh. Para secilit varr pati përkulje. Shpresoj që një ditë të shoh dicka të tillë edhe në Kosovë", u shpreh në FB, Ambasadorja e Kosovës në SHBA Vlora Çitaku.



## BISEDA ME PAKICËN MAQEDONASE NË PUSTEC

Në vijim të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, sot në Pustec bashkëbiseduam me përfaqësues të pakicës maqedonase për zbatimin e projekteve konkrete që synojnë përmirësimin e jetës së tyre. Ligji për pakicat kombëtare miratuar së fundmi në Kuvend është dëshmi e qartë e angazhimit tonë për përmbushjen e standardeve më të larta ndërkombëtare në fushën e pakicave, ishte postimi i Ministrit të jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati.



## MEDIACitate

Kontesti rreth kufirit me Malin e Zi ka shpërfaqur më së qarti kufijtë që i ndajnë subjektet politike përbrenda koalicionit, por edhe ato të opozitës. Për këtë temë asnjëri kamp nuk flet me një zë. Por nuk është kjo një temë e vetme. Për një numër çështjesh, përçarje jo të vogla vërehen midis subjekteve kryesore që tani përbëjnë pushtetin. AAK-ja e Nisma iu bashkuan PDK-së pas një armiqësie të demonstruar me të në mandatin e shkuar dhe të tillat nuk janë pushuar edhe tash kur ndodhen në koalicion. Kur ato janë bashkuar, pajtimin e kanë mbërritur vetëm për postet qeveritare. Ngjashëm sikurse AAK-ja e Nisma, marrëveshjen e demarkacionit nuk e mbështet edhe Lista Serbe, parti kjo kryesore në pushtet nga radhët e komuniteteve pakicë. Kjo listë mban peng edhe formimin e ushtrisë dhe një numër ligjesh, përfshirë atë për arsimin e lartë, ngaqë "veto" si në procesin e votimit të ndryshimeve kushtetuese, e po ashtu edhe të një numri ligjesh.

("Koha ditore", 17 dhjetor)

Lidhja Demokratike e Kosovës ka një kusht për ta votuar marrëveshjen për Demarkacionin me Malin e Zi. E ky kusht sipas LDK-së, është kërkim falja e kryeministrit të vendit, Ramush Haradinaj në lidhje me demarkacionin. Deputeti i kësaj partie, Naser Osmani ka thënë se LDK do ta votojë këtë marrëveshje ngase është parti institucionaliste dhe shtetformuese. "Do ta votojmë atëherë kur kryeministri i vendit do të dalë dhe të kërkojë falje publike para qytetarëve të Kosovës për krejt atë që ka ndodhur kur është procedua në Kuvend i njëjti dokument i cili ky kryeminister e ka votuar me dorën e vetë". "LDK ka krijuar qëndrimin e saj për demarkacionin në kohën kur komisioni e ka kryer punën dhe në kohën kur është vërtetuar punën e komisionit si dhe në të dhënat konkrete", ka thënë Osmani.

(zëri, 16 dhjetor)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## Historia e Gjilanit

Qyteti i Gjilanit është themeluar në gjysmën e dytë të shek.XVIII, pasi pushoi jeta në qytetin mesjetar të Novobërdës.

Gjilani u rrit dhe mori pamjen e një qendre të urbanizuar pas shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga Nishi, Leskovci e Vranja (1878), një pjesë e së cilës u vendos në këtë trevë. Popullsia e pellgut të Moravës dhe e qytetit ka

dhënë një ndihmesë të rëndësishme në luftën kundër sunduesve osmanë, sidomos në kryengritjet e mëdha antiosmane të viteve 1910-1912. Më 1913 Gjilani iu aneksua Serbisë. Pas Luftës I Botërore ka qenë qendër rrethi, që për nga sipërfaqja e popullsisë zinte vendin e dytë në Jugosllavi. Pas Luftës II Botërore Gjilani mbeti qendër e pellgut të Moravës.



Mbetet të shihet nëse LSDM dhe BDI të hënën siç ka paralajmëruar Zaev do të procedojnë emrat për dikastere qeveritare në Parlament, apo të pritët dita e mërkurë kur do të kthehet nga SHBA kryetari i ASH-së Ziadin Sela që përfundimisht të dihet nëse ASH do të jetë apo jo pjesë e Qeverisë.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 17 dhjetor - Plotësimi i vendeve vakante në Qeveri, do të mbetet pezull deri të mërkurën, kur dhe pritët të kthehet nga vizita në SHBA kryetari i Aleancës për shqiptarët Ziadin Sela, përveç nëse dy partnerët tjerë qeveritar, Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë dhe Bashkimi Demokratik për Integritim, mund të marrin vendime të njëanshme para kësaj dite. Kjo, pasi kryeministri Zaev të shtunën, pas mbledhjes së përbashkët qeveritare me Qeverinë e Shqipërisë në Pogradec, deklaroi se të hënën do të procedojnë emrat për poste qeveritare në Parlament.

Siç deklaroi për gazetën KOHA, nënkryetari i ASH-së, Elmi Aziri, vetëm pas takimit Sela - Zaev do të dihet përfundimisht për pozicionin e partisë së tij në Qeveri.

Deri të mërkurën kur pritët të kthehet nga vizitat në SHBA kryetari Ziadin Sela, nuk asgjë konkrete rreth pozicioneve tona në Qeveri. Në takim mes kryetarëve të dy partive do të dihet përfundimisht se çka ne si parti do të pranojmë e çka jo", thotë për gazetën KOHA, Elmi Aziri.

Në pyetjen tonë çka nëse LSDM dhe BDI, siç ka paralajmëruar Zaev, të hënën do të procedojnë emrat në Parlament dhe nuk do të presin Selën, Elmi Aziri thotë se ASH-së nuk i intereson aspak raportin e LSDM me BDI-në, por se partia e tij ka negociuar pushtetin me LSDM dhe po këtë parti do të presin çfarë do të thotë gjatë takimit të liderëve. "Jemi të njohur me atë deklaratë, por

SHUMË AFËR PLOTËSIMIT TË VENDEVE VAKANTE NË QEVERI

# ASH PRET TË MËRKURËN TË TAKOHEN ZAEV DHE SELA



shikoni, neve aspak nuk na intereson raporti mes LSDM-se dhe BDI-së, meqë ne pushtetin e kemi negociuar me LSDM-në, kur ajo kishte mandatin për ta formuar qeverinë. Nëse nuk presin, është punë tyre, por nëse LSDM pret, atëherë do të presim se çka do të thonë konkretisht pas takimit të liderëve, përfshi edhe për zërat që qarkullojnë në opinion se kinse LSDM do të udhëheq me Shëndetësinë", theksoi Elmi Aziri.

Nënkryetari i ASH-së mohan se ka pasur ofertë konkrete nga LSDM në formën "merre ose lëre" për pozicionet në qeveri. "Njerëzit flasin, mediat po ashtu, kam dëgjuar dhe vetë funksionarë të ndryshëm në qeveri të thonë jo ashtu, jo kështu, por se nga LSDM në ASH nuk është dërguar asnjë ofertë konkrete për pozicionet në qeveri. Ato që dolën në disa portale, se LSDM na paska kërcënuar me merre ose lëre, është janë insinuata dhe të pavërtetë që ndoshta i interesojmë dikujt tjetër që njihen për role destruktive në këtë shtet, dhe prej të cilëve jo rrallë ka pësuar interesi ynë kombëtar", thotë Elmi Aziri.

I njëjti shton dhe atë se ASH ka vullnetin e plotë të kontribuojë për integritet euroatlantike të Maqedonisë përveç përsheptimit të reformave në vend. "ASH ka vullnetin e plotë që të vazhdojë të kontribuojë për reformat në vend, gjegjësisht përsheptimit e tyre dhe të jetë pjesë e dinamizmit të rrugëtimit të

Maqedonisë drejt NATO-së dhe afrimit të vendit me BE-në. Ne do të jemi pjesë e Qeverisë reformatore, por asnjëherë të përkulur dhe të ofenduar,"përfundon Elmi Aziri, nënkryetari i ASH-së.

Edhe pse Zaev paralajmëroi se të hënën do të procedohet e emrat në Parlament në BDI, as të dielën nuk pati informacione të prera se cilat do të jenë emrat e rinj në postin e ministrit pa resor që mbulon investimet e huaja në vend dhe zëvendësministrit të arsimit. Ndërkohë në prapaskenë, BDI këmbëngul që ASH të mos udhëheq më sektorin shëndetësisë, ndryshe nga ASH që insiston që të udhëheq më këtë sektor deri në një rikonstruim të gjerë qeveritar para ose pas Samitit të NATO-s në qershor të vitit të ardhshëm. Duket që si rrjedhojë e këtyre luftërave të brendshme të partnerëve të koalicionit qeveritar, nga LSDM dolën zëra se do t'i ofrojnë ASH-së zëvendëskryeministër për Reforma, e së fundmi plus dhe zëvendësministër të shëndetësisë. Nga ASH këto zëra i interpretuan si presion që i bëhet kësaj partie pas koalicionit që kishte në nivel lokal me Lëvizjen BESA, që të lëshojë pe për shëndetësinë. Por, sipas asaj që thotë për gazetën KOHA sekretari i përgjithshëm i LSDM-së, Aleksandër Kiracovski, duket që LSDM dhe BDI mund të kenë marrë vendim që të qeverisin pa ASH, por që presin që kjo e fundit të refuzojë zyrtarisht

propozimet e Zaevit për zëvendëskryeministër për Reforma. I njëjti, pra Kiracovski, një javë më parë tha jo zyrtarisht për gazetën KOHA se më shumë gjasa janë që shëndetësia t'i takojë ASH-së. Gazeta KOHA për të sqaruar më tej këtë dilemë mori informata jozyrtare edhe nga funksionar tjerë të LSDM-së, të cilët thanë se ASH do të mbajë shëndetësinë nga 3 deri në 5 muaj kur dhe mund të ketë rikonstruim të gjerë të Qeverisë. Ndryshe, ASH ka më shumë se dy javë që ka përcjellë zyrtarisht emrin e mjekut Vullnet Ferati nga Tetova për ministër të Shëndetësisë deri te zyra e Kryeministrit. Nga LSDM, nëse vendoset që me Shëndetësinë të udhëheq kuadër nga kjo parti, e kanë gati emrin e neurokirurgut Venko Filipçe. Por, nga lëvizjet e fundit në Qeveri dhe Parlament, gjegjësisht nga dorëheqja e ministrit pa resor Samka Ibrahimovski dhe dorëheqjes së dy deputetëve të LSDM-së Vasko Kovaçevski dhe Stevo Pendarovski, dhe afrimit me LSDM-në të deputetit tjetër rom, Amdi Bajram dhe deputetit nga koalicioni i VMRO-së me partitë tjera, Çedomir Sazdovski, në një farë mënyre jep të kuptohet se LSDM dhe BDI ndoshta mund ta kenë ndarë mendjen të qeverinë pa ASH-në. Këtë variant e përforcon fakti se nga LSDM thonë se RDK e Vesel Memedit vazhdon të jetë pjesë e Qeverisë, por ndaj ASH-së nuk kanë qëndrim koherente, duke koketuar me



ELMI AZIRI

**Neve aspak nuk na intereson raporti mes LSDM-se dhe BDI-së, meqë ne pushtetin e kemi negociuar me LSDM-në, kur ajo kishte mandatin për ta formuar qeverinë. Nëse nuk presin, është punë tyre, por nëse LSDM pret, atëherë do të presim se çka do të thonë konkretisht pas takimit të liderëve, përfshi edhe zërat që qarkullojnë në opinion se kinse LSDM do të udhëheq me shëndetësinë**

poste qeveritare. Sa i përket numrave në Parlament, LSDM bashkë me BDI-në dhe RDK-në kanë 60 vende, ndërsa shumica pa ASH mund të plotësohet me deputetin Çedomir Sazdovski pra 61, pa mos përjashtuar as deputetin Amdi Bajram apo dhe dy deputetët e PDSH-së, kryetari Menduh Thaçi dhe Merale Yzeiri Ferati. Kjo e fundit i ka dhënë për kraheje Qeverisë reformatore të Zoran Zaevit. Gazeta KOHA bëri përpjekje të kontaktojë disa herë me nënkryetarin e PDSH-së Orhan Ibrahim dhe ish deputetët Bekim Fazliu dhe Imer Aliu, për të mësuar nëse PDSH ka biseda me LSDM dhe BDI-ën për të qenë pjesë e Qeverisë.

## SHQIPËRI – MAQEDONI, MARRËVESHJE BILATERALE

Shkup, 17 dhjetor - Seanca e përbashkët që u mbajt të premtën në Pogradec midis Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë, përfundoi me nënshkrimin e disa marrëveshjeve bilaterale midis dy vendeve. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev firmosën Deklaratën për mbledhjen e parë të përbashkët midis dy qeverive si dhe firmosën Memorandumin për



mirëkuptim për mbrojtje dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm

të grupeve radikale që çojnë drejt akteve terroriste. Më pas ministri i

Punëve të Jashtme të Maqedonisë, Nikolla Dimitrov dhe ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati firmosën planin për bashkëpunim dhe konsultime periodike midis ministrive. Memorandumin për forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm, u nënshkrua nga zëvendësministër i Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Julian Hodaj dhe ministrit të Punëve të Brendsh-

me të Maqedonisë, Oliver Spasovski. Ndërsa Memorandumin për bashkëpunimin ndërmjet drejtorive të arkivave të Shqipërisë dhe Institutit për Trashëgiminë Kulturore dhe Shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë e firmosën Skender Asani drejtori i Institutit për Trashëgiminë Kulturore dhe Shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë dhe Ardit Bido, drejtor i Arkivit të Republikës së Shqipërisë. (Z.V.)

## QEVERIA PO PËRGATIT LIGJ ANTIPOPULLOR

Ylli Marku, drejtues i "Western Union", agjencisë për transferta të shpejtë të pareve, thotë se me ligjin e ri Qeveria e re ka për qëllim kontrollimin e dërgesave të parave të mërgimtarëve përmes sistemeve financiare legale dhe do të prekë shtresat e varfra, e sidomos shqiptarët që janë dërguesit më të shumtë të parave



## EDHE PARAT E MËRGIMTARËVE

## DO TË TATIMOHEN



YLLI MARKU

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 17 dhjetor – Nga janari i viti 2018, të gjithë qytetarët e Maqedonisë, përveç obligimit të paraqitjes se tatimit personal brenda një viti kalendarik, do të detyrohen të paraqesin edhe paratë që qytetarët i pranojnë si transferta private përmes shërbimeve të shpejta, siç janë "Western Union" apo "Money Gram". Ministria e Financave paralajmëron se së shpejti do të jetë gati Propozim ligji që ka për qëllim t'i detyron dhënësit e shërbimeve të transfertave të shpejta si dhe agjentët tjerë, t'i paraqesin të gjitha transferuat, të cilat qytetarët tanë që jetojnë dhe punojnë jashtë Maqedonisë, ua dërgojnë familjarëve të tyre dhe të njëjta t'i paraqesin në Drejtorinë për të Hyra Publike (DHP).

"Drejtoria për të hyra publike nuk disponon më të dhëna të sakta për tarnsfertat e qytetarëve përmes shërbimeve të shpejta të parave nga subjektet që deri më sot kanë ofruar kësi lloj shërbimesh dhe nuk kanë qenë të detyruar të dorëzojnë të dhënat për transak-

sionet e kryera të parave deri të Drejtoria për të Hyra Publike", thuhet në ueb faqen e Regjistrat të Vetëm Nacional Elektronik të Republikës së Maqedonisë (ENER). Nëse ky Propozim ligj miratohet para përfundimit të këtij viti, atëherë sipas ENER, subjektet dhe agjentët privat që do të kryejnë shërbime të shpejta të parave të emigrantëve që u dërgojnë familjarëve të tyre, nga janari i viti të ardhshëm do të detyrohen për çdo muaj të dorëzojnë raporte financiare për të gjitha transakcionet individuale për transferim parash. Përveç që duhet t'i dorëzojnë Bankës Popullore të Maqedonisë, këtë duhet ta bëjnë edhe në DHP, e cila në këtë mënyrë do të disponon me të gjitha të dhënat e parave të transferuar nga mërgimtarët drejt familjeve të tyre në Maqedoni.

Sjellja e këtij Ligji, për ekspertin ekonomik, Marjan Petreski, është shumë i rëndësishëm për shkak të dërgesave të mëdha që emigrantët i dërgojnë familjarëve të tyre në Maqedoni. Vlerësimet e para janë se këto dërgesa në nivel vjetor kapin shifrën prej 10 për qind nga Bruto

Prodhimi Vendor. "Është e drejtë që shteti të ketë qasje të saktë se sa janë remitencat e qytetarëve që dërgohen drejt Maqedonisë. Mirëpo, çdo përpjekje që të tatimon apo të shfrytëzohen si të dhëna për të kontrolluar gjendjen financiare të familjeve që janë bartës të ndihmave sociale, mund të rezultojnë me uljen drastike të transfertave të kështilla dhe nga viti i ardhshëm këto para, në vend që të dërgohen përmes sistemeve fiskale legale, do të dërgohen përmes rrugëve tjera jo legale, për shembull, përmes linjave të autobusëve. Për momentin, të dhënat jo zyrtare janë se një pjesë e madhe e remitencave edhe ashtu dërgohen përmes kanaleve joformale. Prandaj, nëse fillon të zbatohet ky ligj, edhe pse në shikim të parë duket se mund të ketë efekte pozitive, duhet të kihet kujdes, sepse efektet negative mund të jenë më të mëdha se efektet pozitive", thotë Marjan Petreski, profesor universitar në Kolegjin Amerikan në Shkup.

Ylli Marku, drejtues i "Western Union", agjencisë për transferta të shpejtë të pareve, thotë se me këtë

ligj preken shtresat e varfra dhe sidomos shqiptarët. "Cilën popullatë më së shumti do të prek ky ligj, kuptohet xhepin e popullatës shqiptare, sepse dërgues më të mëdhenj të remitencave janë mërgimtarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Nëse qeveria e mëparshme bëri çmos që të largon të rinjtë shqiptarë jashtë shtetit, duke mos u ofruar atyre një vend pune, tani kjo qeveri, më masa antipopullore, dëshiron përmes këtij ligji t'ua merr paratë të rinjve shqiptarë që punojnë jashtë shtetit dhe të cilët një pjesë të fitimit ua dërgojnë familjarëve të tyre", thotë Marku.

Sipas Markut, aspak nuk mban arsytimi se më këtë ligj shteti dëshiron të vendosë rend sa i përket dërgesave të mërgimtarëve përmes tarnsfertave të shpejta, sepse asnjë shtet në botë nuk ka ligj të kështillë. "Përmes këtij ligji Qeveria aktuale dëshiron të ketë kontroll të plotë të parave të shqiptarëve si dhe agjencitë që kryejnë shërbime të shpejta për dërgimin e parave familjarëve të tyre. Qëllimi i vetëm është të tatimohen edhe këto para

**Cilën popullatë më së shumti do të prek ky ligj, kuptohet xhepin e popullatës shqiptare, sepse dërgues më të mëdhenj të remitencave janë mërgimtarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Nëse qeveria e mëparshme bëri çmos që të largon të rinjtë shqiptarë jashtë shtetit, duke mos u ofruar atyre një vend pune, tani kjo qeveri, më masa antipopullore, dëshiron përmes këtij ligji t'ua merr paratë të rinjve shqiptarë që punojnë jashtë shtetit dhe të cilët një pjesë të fitimit ua dërgojnë familjarëve të tyre**

të shqiptarëve të fituara jashtë vendit dhe më këtë të mbush sa ma shumë arkën shtetërore. Ky ligj do të ketë efekte negativ, sepse mërgimtarët shqiptarë në të ardhmen do të dërgojnë më pak para përmes sistemeve legale financiare dhe se do të gjejnë një rrugë tjetër ilegale që do t'i dërgojnë para familjarëve të tyre" thotë Ylli Marku, drejtues i Agjencisë për transfertë parash "Western Union".

## CILËSIA E AJRIT PRITET PËRMIRËSOHET

## Gatishmëria e masave në nivelin më të lartë

Shkup, 17 dhjetor - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor rregullisht dhe në bazë ditore përcjell gjendjen, të cilat ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe në shëndetin e qytetarëve. Edhe pse sipas informacionit të Drejtorisë për Çështje Hidrometeorologjike për këto ditë, parashikimi i motit do të jetë i volitshëm, institucioneve iu apelohej që të jenë të përgatitur në rast të tejkalimit të pragut të vlerave të lejuara të PM grimcave në ajër.

Ministria e Mjedisit kërkon që njësitë e vetëqeverisje lokale të jenë të gatshme për uljen e çmimit të biletës të transportit publik ose të sigurojnë bileta falas, që do



të ishte stimul për qytetarët të shfrytëzojnë transportin publik. Të intensifikohet pastrim ditor i hapësirave rrugore dhe atyre për këmbësorë dhe të rriten kontrol-

let inspektuese në vendet e ndërtimit, të menaxhuesit me vajrat e mbetjeve dhe serviset që punojnë me ndërrimin e vajrave.

Ministria, kujton kompanitë

ndërtimore se janë të obliguara të shfrytëzojnë ujë për uljen e pluhurit gjatë aktiviteteve ndërtimore (spërkatjes, larjen e gomave para daljes nga vendi i ndërtimit etj.), dhe kanë obligim makinerinë ndërtimore deri në orën 7:30 të mëngjesit ta çojnë në vendin e ndërtimit.

Njëkohësisht qytetarëve iu rekomandojmë që pa nevojë mos shfrytëzojnë automobilat e tyre, por të përdorin transport publik. Për ngrohje të shtëpive, mos përdorin mbeturina, vajra të djegur të makinerive. Të përdoret dru i pastër dhe i thatë. Njëkohësisht, Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit konform kompetencave të tij të in-

tensifikojë kontrollin e inspektimit për respektimin e dispozitave ligjore, dhe nëse konstaton parregullsi gjatë punës nga kompetencat e tyre të merren masat e duhura.

Në kuadër të përcjelljes së gjendjes dhe ndërmarrjes të masave urgjente kundër ndotjes së ajrit, ditëve të ardhshme do të mbahen takime intensive me grupin ndërsektorial të punës për mjedisin jetësor në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Grupi i intervenimit dhe aksionit, i përbërë nga përfaqësues të kabinetit të kryeministrit, Ministrisë dhe Qytetit të Shkupit.

MË SHUMË OFERTUES NË TREGUN ENERGETIK

# KONKURRENCA SI NË TELEKOMUNIKACION



Me liberalizimin e tregut energjetik parashikohet që deri në fund të vitit të ardhshëm, qytetarët do të mund të blejnë rrymë nga më shumë kompani, ngjashëm si ofertat e tregut në telekomunikacion

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 dhjetor- Ligji i ri i energjetikës që pritet të miratohet në fund të muajit mars të vitit 2018, do të sjellë edhe konkurrencë më të madhe në furnizimin me rrymë. Me liberalizimin e tregut energjetik parashikohet që deri në fund të vitit të ardhshëm, qytetarët do të mund të blejnë rrymë nga më shumë kompani, ngjashëm siç janë me ofertat në tregun e telekomunikacionit. Gjithashtu ligji parashikon që për ata qytetarë që nuk do të zgjedhin furnizuesin, me energji elektrike do t'i furnizojë i ashtuquajtur "furnizues universal", si firmë që do të zgjidhet në ankand publik në çdo pesë vite. Në këtë mënyrë garantohet se asnjë konsumator nuk do të mbetet pa rrymë. Njëherazi, furnizuesit me rrymë do të obligohen që të ofrojnë që në ofertat e tyre të përfshijnë edhe tarifat e ndryshme të lira, ngjashëm me përvojën e deritanishme të shfrytëzimit të energjisë elektrike.

Nga Ministria e Ekonomisë, si propozuese e Ligjit të ri për energjetikë, thonë se tarifa e lirë e rrymës garantohet si kusht minimal në procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, ndërsa forma do të vret nga oferta e furnizuesit, të cilin qytetarët do të mund të zgjedhin në tregun e lirë. "Me Liberalizimin e tregut do të rritet edhe konkurrenca dhe cilësia e shërbimeve, ndërsa praktika evropiane ka treguar se kur ekziston konkurrencë në

treg, ofrohen edhe lehtësi shtesë për qytetarët nga ana e furnizuesve. Gjithashtu, me qëllim të mbrojtjes më të madhe të qytetarëve në Propozim ligjin e ri për energjetikë, do të vendoset edhe furnizuesi universal që do të duhet të sigurojë shërbim cilësor, me çmime më të lira për shfrytëzuesit, përfshi edhe tarifen e lirë", thonë nga Ministria e Ekonomisë. Nga ana tjetër, në nenin 27, përcaktohet që me Ligjin e ri për energjetikë do të balancohen interesat e furnizuesve dhe konsumatorëve si dhe parashikohet mbrojtja e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve të sistemit nga çfarëdo keqpërdorimi të pozitës dominante në treg.

Në ndërkohë, zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, thotë se konkurrenca më e madhe do të sjellë edhe çmime më të volitshme.

" Propozim ligji për energjetikë shkon në favor të qytetarëve të Maqedonisë, ndërsa do të mundësojë konkurrencë më të madhe lidhur me furnizimin me të gjitha energjenset. Atje ku ekziston konkurrenca, ka edhe ulje të harxhimeve, nuk ka biznese të rregulluara, nuk ka harxhime të paarsyeshme dhe nuk ekziston komoditeti i kompanive energjetike që të paraqesin harxhime që nuk arsyetohen, të cilat duhet t'i paguajnë të gjitha qytetarët", thekson Angjushev.

Pritet që në vitet e ardhshme me çmimin më konkurrues të rrymës që do ta prodhojnë Elektranat e Maqedonisë, përdorimin më të

madh të gazit në amvisëri dhe industri, paraqitjen e kompanive të reja që do të ofrojnë rrymë për shitje, që të gjithë lojtarët në tregun energjetik të garojnë me oferta më të mira për konsumatorin.

Ndryshe, përvojat kroate që liberalizoi tregun energjetik para pesë vitesh, tregojnë se çmimi fiks i kompanisë shtetërore të rrymës HEP apo Elektro-ekonomisë kroate është 0.3495 kuna për kilovat orë, në kushte kur për një euro paguhen shtatë kuna. Kjo kompani mban 91 për qind të tregut. Kompania RVE energji, që mban 5 për qind të tregut, ofron çmim prej 0.3803 kuna për kilovat orë, ndërsa në treg ekzistojnë edhe tre ofertues të tjerë më të vegjël. Ofertat në treg të HEP janë çmimi fiks për tërë kohën e furnizimit, ndërsa RVE energji ofron çmime në varësi prej gjatësisë së kontratës. HEP ofron që vetë konsumatorët ta lexojnë konsumin e rrymës, duke i liruuar prej çmimit prej afër 1 euro plus TVSH, ndërsa ofron edhe kursime shtesë prej 2.7 për qind përmes klubit të tyre. RVE energji ofron lirim prej 10 për qind në tre vitet e para dhe lirim prej 7 për qind në dy vitet e para për ofruesin universal, 2 për qind shtesë për marrëveshjen onlajn, një muaj gratis në 12 muaj për çdo konsumator të ri që ju e sillni në rrjet dhe konsultime falas për kursimet në amvisëri. Gjithashtu, nga një janari 2017 në Kroaci për qytetarët që blejnë rrymë është zvogëluar TVSH-ja për shpërndarjen e rrymës prej 25 në 13 për qind.

**Përvojat kroate që liberalizoi tregun energjetik para pesë vitesh, tregojnë se çmimi fiks i kompanisë shtetërore të rrymës HEP apo Elektro-ekonomisë kroate është 0.3495 kuna për kilovat orë, në kushte kur për një euro paguhen shtatë kuna. Kjo kompani mban 91 për qind të tregut. Kompania RVE energji, që mban 5 për qind të tregut, ofron çmim prej 0.3803 kuna për kilovat orë, ndërsa në treg ekzistojnë edhe tre ofertues të tjerë më të vegjël.**

## KRONIKË

### Dy vajza lëndohen në Shkup

Të shtunën në mbrëmje, në rrugën "Filipi i Dytë", automjeti "Folksvagen Bora" me targa të Shkupit, drejtuar nga Lj.Z. (36), ka goditur dy vajza nga Shkupi. Në fatkeqësi, lëndime pësuan dy vajzat, të cilat me automjet tjetër u dërguan në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "Shën Naumi i Ohrit", ku iu ofrua ndihma mjekësore, kumtoi MPB. Tek njëra vajzë u konstatuan lëndime të rënda trupore dhe u mbajt për mjekim të mëtutjeshëm, përdërisa tek tjetra vajzë janë konstatuar lëndime trupore dhe është dërguar në Klinikën për vesh, hundë dhe fyt pranë Qendrës klinike "Nëna Terezë" Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi nga SPB Shkup.

### Sulmohet me armë një veturë

Deri më tani një person i panjohur ka shtënë dy plumba nga një armë zjarri në veturën e tipit "Mercedes" Xhip, me targa të Tetovës, pronë e A.B nga Tetova. Vetura në fjalë, drejt së cilës është shtënë me armë zjarri, ka qenë e parkuar në rrugën " Boris Kidriç", nga ana e SH.B. 30 vjeçar, përndryshe djalit të pronarit të veturës. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për gjetjen e autorit si dhe zbardhjen e plotë të rastit.

### Aksident në qendër të Tetovës

Në bulevardin "Mareshall Tito" në Tetovë ka ndodhur një aksident komunikacioni ku janë përfshirë dy vetura, edhe atë një veturë e tipit "Shkoda" e drejtuar nga 26 vjeçari me iniciale A.S nga Tetova si dhe një "Mercedesi" me targa të Tetovës, e drejtuar nga SH.S 63 vjeçar nga Tetova. Në këtë aksident, për pasojë, lëndime trupore ka marrë SH.S. Ai me anë të një veture tjetër është dërguar në spitalin klinik të Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës mjekësore është lëshuar nga spitali për mjekim shtëpiak. Ekspertizë në vendngjarje ka kryer një ekip i Sektorit për punë të brendshme në Tetovë si dhe po punohet në zbardhjen e plotë të shkaqeve si dhe rrethanave në të cilat ka ndodhur ky aksident.

## EDHE TREVJET DO TË PRESIM GAZIFIKIMIN



Për vitin 2018 janë siguruar 32 milionë euro për infrastrukturën e gazsjellësit si dhe të holla shtesë prej 10 milionë euro nga Resurset Energjetike të Maqedonisë, që janë dedikuar për tjetërsimin e tokës dhe çështjet e tjera pronësore-juridike. Pas zgjidhjes së problemeve pritet të intensifikohet ndërtimi edhe në krahun Shkup-Gostivar

Pritet që me zgjidhjen e problemeve me tjetërsimin e tokës dhe pagesës së saj për pronarët si dhe ndërtimin e rrjetit sekondar, që në 2020 më në fund edhe të gazifikohet vendi

# NË 2020, NGROHJE ME GAZ

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 dhjetor - Gazifikimi në Maqedoni, që si projekt paralajmërohet që nga viti 2007, akoma ka mbetur projekt i papërfunduar. Qytetarët, si duket do të duhet të presin së paku deri në vitin 2020 për të shfrytëzuar benefitet e ngrohjes më të lirë me gaz. Pritet që me zgjidhjen e proble-

meve me tjetërsimin e tokës dhe pagesës së saj për pronarët si dhe ndërtimin e rrjetit sekondar, që në 2020 më në fund edhe të gazifikohet vendi. Paraprakisht, dësh-tuan tre përpjekje për gazifikimin e tërësishëm të Maqedonisë. Në Maqedoni aktualisht po ndër-tohen tre gazsjellës magjistrat prej Shtipi deri në Negotinë, i gjatë 36 km, prej Negotinë deri në

Manastir i gjatë 92 km dhe prej Shkupi deri në Gostivar i gjatë 76 km. Në periudhën e kaluar, u përfundua gazsjellësi prej Kleçovce të Kumanovës deri në Shtip, ndërsa në vitet 90-të të shekullit të kaluar u ndërtua lidhja me Bullgarinë dhe u siguroa gaz natyror për Kriva Pallankën, Kumanovën dhe Shkupin. Në kryeqytetin e Maqedonisë aktualisht shumë pak sh-

frytëzohet gazi natyror dhe atë vetëm nga një pjesë e industrisë, disa objekte shëndetësore, dhe shkollave fillore dhe të mesme në Shkup. Vonosa në ndërtimin e rrjetit sekondar pamundëson që edhe e amvisëritë të shfrytëzojnë gazin për ngrohje. Në ndërkohë, nga kompania shtetërore Resurset Energjetike të Maqedonisë thonë se në teren ekzistojnë probleme

## RRETH 1500 PERSONA ME INVALIDITET KËRKOJNË NJË VEND PUNE!

## Shteti diskriminon personat me aftësi të kufizuara

Koha Aida XHONI

Shkup, 17 dhjetor - Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të hasin në vështirësi për tu punësuar. Të dhënat zyrtare të Agjencia për Punësim në Maqedonisë (APRM), thonë se vitin e kaluar janë evidentuar rreth 1500 persona me invaliditet, të cilët aktivisht kanë kërkuar punë. Nga Organizata për persona me invaliditet "Shpresa" në Shkup, thonë se mungon vetëdija e institucioneve për të adaptuar fillimisht objektet e pastaj për të punësuar personat me aftësi të kufizuara në punë. Sefer Hyzeni, kryetar i shoqatës "Shpresa", thotë për gazetën KOHA se kjo organizatë numëron mbi 500 anëtarë, ndërsa vetëm pesë apo gjashtë prej tyre janë të punësuar.

"Organizata e personave me aftësi

"Organizata e personave me aftësi të kufizuara 'Shpresa' numëron diku mbi 500 anëtarë të kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Për momentin, prej tyre vetëm 5 apo 6 janë të punësuar...", ankohet Sefer Hyzeni

të kufizuara 'Shpresa', numëron diku mbi 500 anëtarë të kategorive të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara. Për momentin, prej tyre vetëm 5 apo 6 janë të punësuar, kohën e fundit ka lëvizje të përmirësueshme në këtë drejtim, por ende duhet të vetëdijësohen institucionet shtetërore si dhe ato private, sidomos edhe këta persona të kyçen nëpër vendet e ndryshme të punës. Mendoj në punësim përkatës të vendeve për ku janë të kualifikuar.



të shumta në realizimin e sipër të procesit të gazifikimit siç janë tjetërsimi i tokës në krahun Shkup-Tetovë-Gostivar dhe krahun prej Negotinë deri në Manastir. "Në fillim të shtatorit krahun Kleçovce deri në Shtip e kemi lidhur me gazsjellësin ekzistues të GAMA dhe në periudhën e ardhshme do të ketë tender për përzgjedhjen e kompanisë me çka më në fund ai pritet të lëshohet në funksion deri në muajin prill të vitit 2018. Krahu i dytë prej Shtipi deri në Negotinë, është i ndërtuar mbi 85 për qind dhe përkundër problemeve më të vogla me tjetërsimin e tokës pritet të përfundojë deri në vitin e ardhshëm. Krahu prej Negotinë deri në Manastir është i ndërtuar me vetëm 14 për qind për shkak të problemeve të pazgjidhura pronësore –juridike që duhet të zgjidhen me pagesën e mjeteve prej afër 1 milion euro", thotë drejtori i Resurseve Energjetike të Maqedonisë, Blagojçe Kotevski.

Sipas tij, për vitin 2018 janë siguruar 32 milionë euro për infrastrukturën e gazsjellësit si dhe të holla shtesë prej 10 milionë euro nga Resurset Energjetike të Maqedonisë, që janë dedikuar për tjetërsimin e tokës dhe çështjet e tjera pronësore –juridike. Pas zgjidhjes së problemeve pritet të intensifikohet ndërtimi edhe në krahun Shkup-Gostivar, ndërsa konform marrëveshjes me kryerësit e punës, pritet që tërësisht të ndërtohet rrjeti primar i gazit deri më vitin 2020 në tërë shtetin. Sipas projektit, gazsjellësi Shkup deri në Gostivar, do të jetë i gjatë 76 kilometra, me një krah për Tetovën në Leshnicë të epërme të gjatë 10 kilometra.

Në të ardhmen, sfida për ekzekutivin në nivel lokal dhe qendror mbetet shtrirja sa më e madhe e përdorimit të gazit, rritja e numrit të përdoruesve në amvisëri, duke u ofruar çmime të kapshme për kyçe në rrjet, me qëllim të përdorimi masovik të gazit për ngrohje. Nga Resurset Energjetike të Maqedonisë, thonë se në bazë të ndryshimeve të paralajmëruara të Ligjit për Energjetikë, çdo komunë dhe qytet vetë do të kenë obligimin për ndërtimin e rrjetit sekondar që sjell energjinë deri tek konsumatorët në bazë të studimit fizibilitet, që do të tregojë se sa mjete nevojiten, si dhe mënyrën e gazifikimit. Ekziston mundësia që nëse komunat punojnë në mënyrë paralele me pushtetin qendror që amvisëritë të fitojnë gaz në vitin 2020. Ndryshe, njohësit e energjetikës presin përfitime të shumta si ekonomike dhe ekologjike nga gazifikimi i Maqedonisë ku vendi duhet të fitojë energjinë më të lirë, prodhimtaria industriale me gaz do të sjellë edhe prodhime më të lira dhe më konkurruese në treg. Gjithashtu, gazit do të ndikojë në rritjen e konkurrencës në sektorin e energjetikës për të ulur më tej çmimin e energjiseve të tjera.

Mirëpo, ndër arsyet e para se pse ndodhë kështu është mungesa e vetëdijes institucionale, pasi në radhë të parë – ne si persona me ftesi të kufizuara nuk kemi qasje deri në institucione, enterieri apo shkallët e adaptuara nuk janë dhe ne as nuk mund ti afrohem shumicës së dyerve të institucioneve", ankohet Hyseni. Sipas Institutit për shëndet publik të Maqedonisë, 10 për qind e popullatës apo 200.000 persona në Maqedoni janë me ndonjë të aftësi të kufizuara. Në Agjencinë për Punësim deri më 31 dhjetor të vitit 2016 kanë qenë 1490 persona me aftësi të kufizuara të papunë - kërkues aktiv të punës, 67.6 për qind nga të cilët janë meshkuj apo 1007 persona dhe 32.4 për qind apo 483 janë femra. Personat me aftësi të kufizuara të papunë janë të numëruar në numrin e përgjithshëm të personave të papunë në evidencën e Agjencisë.

"Sipas strukturës së moshës, 18.7 për qind apo 279 nga personat e papunë me aftësi të kufizuara janë të moshës prej 15 deri 19, 52 për qind ose 786 persona të moshës 30 deri 49 vjet dhe 28.5 për qind apo 425 janë të moshës mbi 50 vjet. Sipas arsimimit, pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara të papunë 56.4 për qind apo 841 persona janë pa shkollim fare dhe me arsim fillor, pa përfunduar shkollim të mesëm janë 19.5 për qind apo 290 persona, 20.6 për qind apo 307 prej tyre janë me arsim të mesëm, ndërsa me arsim të lartë janë vetëm 3.5 për qind ose 52 prej numrit të përgjithshëm të personave të evidentuar si të pa punë nga ata me aftësi të kufizuara", thuhet ne Raportin e Agjencisë për Punësim të Maqedonisë për vitin 2016. Ndryshe, Konventën për të drejtat e personave me invaliditet Maqedonia e nënshkroi në 20 mars të vitit 2007, ndërsa e ratifikoi në 5 dhjetor 2011.

## PËR PAK PARA, SHUMË GARDËROBË



# VESHJET E PËRDORURA, LIRË E MIRË

Sipas pronarëve të dyqaneve me veshje të përdorura, në fillim blerësit janë habitur me çmime aq të ulëta, por me kohë kanë kuptuar se edhe te ne mund të blihen brende me kosto shumë të ulët

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 dhjetor - Dyqanet me veshje të përdorura apo "second hand", ose të dorës së dytë, në botë janë të popullarizuara me dekada të tëra. Bile edhe në qendrat e modës si Milano, nuk mungojnë shitore të tilla që janë përplot me blerës. Ka edhe të tilla që mundësojnë jo vetëm blerjen me çmime të pranueshme nga të gjithë, por edhe huazimin e një pjese të gardërobës për disa ditë apo javë. Veshmbathjet e dala nga moda, ato me ndonjë defekt nga fabrika apo edhe të përdorura, nuk do të thotë se janë të pashfrytëzuara.

Përkundrazi, ato madje janë shndërruar në veshje ndër më të kërkuara nga të gjitha moshat dhe llojet e konsumatorëve. Zakonisht, në dyqanet e dorës së dytë nuk shiten rrobat kineze apo turke, por shpesh janë brende të njohura të tekstilit nga shtetet e Evropës Perëndimore.

Në dhjetë vitet e fundit edhe në rajon, por edhe në Maqedoni shënon bum biznesi i veshjeve të përdorura. Pronarët e dyqaneve që ofrojnë mall të tillë, thonë se gradualisht edhe te ne po tejkalohen paragjykimet se është

turp të blihen veshjet e mbajtura. Bile, shtojnë se në vitet e fundit janë shtuar "myshterijet" e rregullt që për pak të holla e rinovojnë gardërobën e tyre. Ndër frekuentuesit më të shpeshtë të tyre janë qytetarët që kanë vizituar më shpesh shtetet evropiane, që kanë vizituar dyqanet e tilla në perëndim, familjet me më shumë anëtarë, por edhe të rinjtë që preferojnë të mbajnë veshje të brenduara për pak para.

Sipas pronarëve të dyqaneve me veshje të përdorura, në fillim blerësit janë habitur me çmime aq të ulëta, por me kohë kanë kuptuar se edhe te ne mund të blihen brende me kosto shumë të ulët.

"Jo çdo herë veshjet që i shesim janë të mbajtura. Dyqanet e brenduara në botë, në fund të sezonit i vendosin mënjatë copat e ndryshme që nuk janë shitur dhe i eksportojnë si mall të dorës së dytë. Veshmbathjet e tilla, së pari duhet të trajtohen në mënyrë kimike nga prania eventuale e të gjitha baktereve që të mund më lehtë të shiten jashtë. Andaj, duhet të jetë e qartë se veshjet e tilla janë tërësisht të pastra, bile edhe nëse dikush i ka mbajtur, për shkak se në dyqane ka edhe gardërobë të tillë që dikush e ka përdorur", thonë në një dyqan të veshjeve të tilla.

Nga ana tjetër, Lumturia, një vizitore e rregullt e dyqaneve të dorës së dytë, thotë se nuk e ka aspak problem të blejë dhe të vesh diçka që edhe mund ta ketë përdorur dikush tjetër më parë.

"Unë blej lloje të ndryshme të gardërobës nëpër dyqane të dorës së dytë. Në krejt Evropën punojnë shitore të tilla të cilat ofrojnë këmbis, pantallona dhe sende të tjera, bile edhe të brendeve botërore që asnjëherë nuk

**Bile, thonë tregtarët, midis butikëve të shtrenjta dhe dyqaneve të "second hand", konsumatorët shpesh zgjedhin shoppingun në butikun e veshjeve të përdorura. Përvoja e tregtarëve të këtyre dyqaneve tregon se shpesh ata frekuentohen edhe nga personalitete të njohura nga jeta publike, ose edhe profesionistë në profesionet me paga shumë më të larta se mesatarja në Maqedoni**

do të kisha të holla t'i blej në dyqanet më qendrat e ndryshme tregtare", shton më tej ajo. Ajo thotë se sapo t'i blejë këto veshje i lan mirë dhe pas tharjes e hekurosjes i vesh si çdo veshmbathje tjetër, duke mos pasur asnjëherë ndonjë alergji apo ndonjë problem tjetër.

Pronarët e këtyre dyqaneve shpesh gojnë se klientët e tyre të rregullt janë me status të ndryshëm ekonomik dhe social, për shkak se të gjithë duan të kujdesen për veten, pa harxhuar shumë të holla. Bile, thonë tregtarët, midis butikëve të shtrenjta dhe dyqaneve të "second hand", konsumatorët shpesh zgjedhin shoppingun në butikun e veshjeve të përdorura. Përvoja e tregtarëve të këtyre dyqaneve tregon se shpesh ata frekuentohen edhe nga personalitete të njohura nga jeta publike, ose edhe profesionistë në profesionet me paga shumë më të larta se mesatarja në Maqedoni. Njohësit e modës në vend, thonë se në këtë treg në rritje, blerësit vijnë për të gjetur ndonjë veshmbathje që u shkon për shtati, pjesë të gardërobës që kur mbahet në trup, i bën ata të duken hijshëm dhe të ndjehen mirë me veten, duke bërë shopping për pak të holla.



Në bazë të nenit 54, 63, 64, 125, 126, 131, 132, 133, 134, 135 dhe 142 të Ligjit për arsim sipëror, nenit 3 paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në Sektorin publik, dhe nenit 22 paragrafi 4 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune

### UNIVERSITETI "GOCE DELLÇEV" – SHTIP

Publikon

#### KONKURS

#### Për zgjedhjen e mësimit në njësive në kuadër të Universitetit

##### 1. FAKULTETI I BUJQËSISË

###### 1.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Inxhinieria ushqimore - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 2. FAKULTETI PËR TURIZËM DHE BIZNES LOGJISTIKË

###### 2.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

- Ekonomikë dhe organizim të turizmit dhe Gastronomi - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

##### 3. FAKULTETI I MAKINERISË

###### 3.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Elementet e makinerisë dhe sistemet teknike dhe Makineria e prodhimit, teknologjitë dhe sistemet - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

##### 4. FAKULTETI TEKNIK-TEKNOLOGJIK

###### 4.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Materialet kompozite dhe Filet tekstile dhe teknike - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

##### 5. FAKULTETI I SHKENCAVE ARSIMORE

###### 5.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Kineziologjia aplikative (sport, edukatë fizike, rekreacion, kineziterapi, e të tjera)- (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 5.2 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Metodika dhe Arsimi i mësimitdhënësve - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

##### 6 FAKULTETI FILOLOGJIK

###### 6.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Gjermanistika dhe Gramatika, semantika, semiotika, sintaksa - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 6.2 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën – mësimore shkencore:

-Letërsia për fëmijë - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 6.3 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor i lartë për sferën shkencore:

-Anglistika - (1 realizues) për kohë prej katër vjet

###### 6.4 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Gjermanistika - (1 realizues) për kohë prej katër vjet

##### 7. FAKULTETI I SHKENCAVE TË MEDICINËS

###### 7.1 Mësimdhënës në titullin Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.2 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor i lartë për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.3 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.4 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.5 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.6 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.7 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.8 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.9 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.10 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.11 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.12 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.13 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.14 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.15 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.16 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.17 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.18 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.19 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.20 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.21 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.22 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.23 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.24 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.25 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.26 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.27 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.28 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.29 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.30 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.31 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.32 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.33 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.34 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.35 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.36 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.37 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.38 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

###### 7.39 Mësimdhënës në titullin mësimit-profesional – Lektor për sferën shkencore:

-Medicina interne - (1 realizues) për kohë prej pesë vjet

dhe notë pozitive nga vetëevaluimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për profesor me korrespondencë mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku pesë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose tre punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vjet e fundit, pjesëmarrje në projekte shkencore-hulumtuese, gjegjësisht arritje të theksuara në aplikimin e rezultateve hulumtuese, kontribut në aftësimin e mësimitdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e lojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevaluimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për profesor të regullit mund të zgjedhjet personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore në të cilën zgjidhet, së paku gjashtë punime shkencore-hulumtuese të publikuara në sferën përkatëse në revistat shkencore ndërkombëtare ose publikime shkencore ndërkombëtare ose katër punime shkencore në revistë shkencore me impakt faktor në pesë vjet e fundit, i cili ka marrë pjesë ose ka udhëhequr në projekte shkencore-hulumtuese dhe ka dhënë kontribut në aftësimin e mësimitdhënësve të rinj dhe i cili ka treguar aftësi për realizimin e lojeve të veçanta të veprimtarisë për arsim sipëror dhe notë pozitive nga vetëevaluimi. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të caktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për lektor të lartë mund të zgjidhet personi i cili ka të mbaruar studimet e ciklit të dytë të sferës shkencore në të cilin zgjidhet, punime të publikuara shkencore dhe profesionale dhe tregon aftësi për punë mësimore. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit – shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Për lektor mund të zgjidhet personi i cili ka mbaruar studimet e ciklit të dytë të sferës shkencore në të cilin zgjidhet dhe tregon aftësi për punë mësimore, zotëron me problemet e disiplinës së vet dhe ka përvojë praktike në punën mësimore. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Shkencëtarët e afirmuar, profesionistët e praktikës dhe artistët të institucionit për arsim sipëror, të cilët i plotësojnë kushtet për zgjedhje në titull, ndërsa për të cilin nuk ka vend të lirë për zgjedhje në titullin mësimit-shkencor, gjegjësisht mësimitdhënës mund të zgjidhen në titullin docent titullar dhe profesor titullar me korrespondencë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për arsim sipëror. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor dhe mësimit të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- Kandidati i cili do të zgjidhet për mësimitdhënës në Fakultetin e shkencave të medicinës (pika 7.1) do të mbajë vendin e punës në institucionin shëndetësor ku është i punësuar, ndërsa në pajtim me marrëveshjen do të mbajë mësimit në Universitetin "Goce Dellçev" – Shtip (neni 133 të Ligjit për arsim sipëror).

- Orari i kohës së punës dhe pagesa:  
- Orari ditor i punës prej 08:30h. deri 16:30h.  
- Orari javor i punës – 40 orë punë (prej ditës së hënë deri në ditën e premte)  
- Neto paga themelore për: Docent -38.143,00 den.; Profesor me korrespondencë - 43.660,00 den.; Profesor i rregullt - 50.311,00 den.; Docent titullar - 700, 00 den./orë; Profesor titullar me korrespondencë - 800,00 den./orë; Lektor i lartë - 31.362,00 den.; Lektor -30.291

**Dokumentet e nevojshme për kandidatët për zgjedhje në titujt mësimit, mësimit – shkencor dhe mësimit-profesional:**

- fletëparaqitje;  
- diplomë për arsim të mbaruar përkatës – për punim të mbrojtur të magistraturës/doktoraturës (një kopje të diplomës në origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter; diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me ekuivalencë të notave);  
- certifikatë për provimet e dhëna të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve  
- biografi të shkurtë (në katër kopje)  
- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale  
- nga një kopje të punimeve;  
- vërtetim se një një prej gjuhëve të huaja  
- rekomandim prej së paku 2 (dy) profesorëve (me korrespondencë rregullt) nga sfera përkatëse shkencore për të cilin bëhet zgjedhja - për kandidatët për docent dhe lektor;  
- rekomandim nga punëdhënësi paraprak (nëse kandidati ka qenë i punësuar) - për kandidatët për zgjedhje docent dhe lektor;  
- një kopje të punimit të magistraturës/doktoratës;  
- certifikatë të shtetësisë;

Konkursi zgjatë 12 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 131 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit).

Dokumentet të dorëzohen në arkivin e:

1. Fakulteti i bujqësisë – rr. "Goce Dellçev" nr. 89, Shtip; tel. 032-550-600;
2. Fakulteti për Turizëm dhe biznes logjistikë – rr. "7-mi Noemri" pn, Gjevgjeli; 032-550-350
3. Fakulteti i makinerisë – rr. "Braka Milladinov" pn Vinicë; tel. 032 550-850;
4. Fakulteti teknik – teknologjik – rr. "Miro Bagara" pn, Probishtip; tel. 032-550-180;
5. Fakulteti i shkencave arsimore - rr. "Krstë Misirkov" nr. 10A, Shtip, tel; 032-550-500;
6. Fakulteti filologjik – rr. "Zheleznička" pn, Shtip; tel: 032-550-180.
7. Fakulteti për shkenca mjekësore – Spitali klinik Shtip rr. "Luben Ivanov" nr. 25 (Departamenti i pediatriisë); tel. 032-550-400;

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysht

Në bazë të nenit 14 paragrafi 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 ), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14 dhe 199/14) dhe nenit 37 - gj të Ligjit për ndërmarrjet publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 41/2014), Ndërmarrja publike për veprimtari komunale Debrca, publikon

#### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për plotësim të vendit të lirë të punës për kohë të pacaktuar

1. NPK "Debrca" – Bellçishtë ka nevojë për punësim të:

Nr. rend	Shifra	Titulli i vendit të punës	Nr. i realizuesve
1	KDR 04 01 A03 012	Punëtor i përgjithshëm	1

2. Marrëdhënia e punës për vendin e punës nga pika 1 për kohë të pacaktuar të punës.

3. Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës.

4. Secili kandidat duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

5. Kandidatët të cilët do të paraqiten për vendin e punës me numër rendor 1 duhet të përmbushin kushtet e posaçme në LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtari komunale dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP për veprimtari komunale Debrca – Bellçishtë, gjegjësisht kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrje publike dhe LMP ose Marrëveshjen kolektive për veprimtari komunale për vendin e theksuar të punës janë:

#### - Kualifikimet profesionale:

- personat ndihmës-teknik të nivelit të parë, me së paku nivel të kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO pse arsim të mesëm katërvjeçar;

6. Kandidatët për punësim paraqiten në shpallje publike përmes plotësimi të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për vendin e lirë të punës duhet të paraqesin:

- Biografi të shkurtë CV
- Dëshmi për arsim të mbaruar (diplomë origjinal ose kopje të vërtetuara në noter)
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter)
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter)

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e bashkëngjitura dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP për veprimtari komunale Debrca f. Bellçishtë.

Shpallja është e hapur 5 ditë duke konsideruar nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e dorëzuar pas afatit, jo të plota dhe të parregulluara nuk do të jenë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për realizim të procedurës për punësim.

7. Procedura për zgjedhje të kandidatëve të paraqitur përbëhet nga kontrollimi i fletëparaqitjeve dhe besueshmëria e të dhënave të shënuara dhe dëshmi të bashkëngjitura me fletëparaqitjen. Mendime deri të drejtori, për zgjedhjen e kandidatëve në lidhje me këtë shpallje do të japë Komisioni për zgjedhje, ndërsa vendimin përfundimtar për zgjedhje do ta sjellë drejtori i ndërmarrjes publike në afatin e paraparë me ligji.

NP për veprimtari komunale Debrca – Bellçishtë  
u.d Drejtor  
Vasil Jonçevski

Në bazë të nenit 138 nga Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sigurim shëndetësor (Gaz.zyrtare e RM nr.43/012) Fakulteti medicinës pranë UKM në Shkup publikon:

#### KOKURS

#### për pranimin e kandidatëve për deriedukim të punëtorëve shëndetësorë-mjek të zgjedhur të medicinës familjare për 3, 6, 9 dhe 12 muaj

KUR NDËRTESET NUK PËRMBUSHIN STANDARDET

# MUNGOJNË EDHE SHKALLËT PËR EVAKUIM

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 17 dhjetor - Pjesa më e madhe e ndërtesave shumëkatëshe në Tetovë, jo që nuk kanë parqe dhe parkingje, por në shumicën prej tyre, mungojnë edhe shkallët ndihmëse për evakuim në raste emergjente. Këto ndërtesa u ndërtuan pa asnjë kriter. Krahas kësaj, problem në vete janë edhe rrugët e ngushta dhe të pakalueshme për makinat e urgjencës, sidomos të zjarrfikësve dhe ndihmës së shpejtë.

Nga Njësia e Zjarrfikësve të Tetovës, thonë se shpesh herë intervenimet realizohen larg vendit të ngjarjes, për shkak të mos pasjes së mundësisë së qasjes edhe të automjeteve, por edhe të zjarrfikësve në këto ndërtesa. Uka Aliti, kryeshef i Njesisë zjarrfikësve të Tetovës, shprehet se vështirësitë gjatë intervenimeve janë të shumta, por brenda mundësisë ata arrijnë që të shmangin edhe më të keqen.

"Kemi shumë intervenime kur nevojiten edhe shkallë të larta për ndërtesa që mungojnë te njësia jonë. Po ashtu në këto ndërtesa mungojnë edhe shkallët ndihmëse. Shumë ndërtesa, por edhe qendra tregtare, janë ndërtuar pa kriter të nevojshme urbanistike dhe shpesh herë evakuimi është bërë me mjete ndihmëse dhe jo nëpërmjet shkallëve për raste urgjente", thotë Aliti.

Rasti i fundit ishte gjatë një intervenimi në pjesën qendrore të Tetovës, ku kishte filluar të përhapet një zjarr dhe mungonin shkallët ndihmëse që shfrytëzohen edhe nga banorët, por edhe nga zjarrfikësit për intervenim më efikas.

"Edhe në këtë qendër tregtare mungojnë shkallët ndihmëse dhe mezi kemi gjetur një shteg për t'u ngjitur dhe të intervenojmë. Fatmirësisht, zjarri ka qenë me përmasa shumë të vogla, por sikur të jetë më i madh, atëherë është problem edhe evakuimi nga katet e

Njësia territoriale kundër zjarrit në Tetovë, vetëm këtë vit ka pasur mbi 600 intervenime, por që, siç thonë të punësuarit, janë realizuar me vështirësi të shumta

më larta të banesave që janë rreth e rrotull qendrës. Duhet që të kenë më shumë kujdes qytetarët kur ndërtojnë ndërtesa të mëdha që këtyre sendeve t'u japin përparësi, sepse me këto shkallë që ndërtohen, shpëtohet jeta e njeriut, por edhe ne mund të punojmë me më shumë efikasitet, ngase nuk kemi se si të ngjitemi në pjesët më të larta", deklaroi kreu i zjarrfikësve të Tetovës. Sipas tij, në Tetovë ka edhe shumë lagje ku qasja është e pamundshme me automjete më të mëdha dhe nëse paraqitet ndonjë zjarr me përmasa më të mëdha efikasiteti i zjarrfikësve është shumë i vogël.



"Ka disa lagje ku janë ndërtuar ndërtesa të larta dhe nuk është lënë hapësirë e mjaftueshme për automjete më të mëdha të zjarrfikësve në rast intervenimi. Gjithnjë kur jemi në këso situata, duhet që të intervenojmë prej së largu dhe kjo nuk ka efektet sikur nga afër ku shpërthen zjarri", shprehet Uka Aliti.

Krahas kësaj, problem janë edhe disa lagje ku nuk ka aspak qasje për këto automjete, sidomos në pjesën qendrore në ndërtesat përreth qendrës tregtare, ku nëse

ka raste urgjente qytetarët do të duhet që vet të gjejnë zgjidhje, për shkak të mungesës së shkallëve ndihmëse, sepse ndihma nga institucionet urgjente është e pamundur për t'u ofruar, sepse edhe nuk ka rrugë për të arritur te ata. Njësia territoriale kundër zjarrit në Tetovë, vetëm këtë vit ka pasur mbi 600 intervenime, por që, siç thonë të punësuarit, janë realizuar me vështirësi të shumta. Njësia e zjarrfikësve të Tetovës numëron 72 zjarrfikës dhe dhjetëra automjete për intervenime gjatë zjarreve.

KONFERENCËS SHKENCORE

## Xhemijeti dhe rezistencën e saj kundër kolonizimit

Shkup, 17 dhjetor - Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve - Shkup, në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese "Logos-A" - Shkup, organizoi konferencën shkencore me temë "Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit".

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se sot është dita kur e shënojmë përvjetorin e themelimit të Xhemijetit dhe për neve kjo është një ditë feste. Por, ne kemi festë jo vetëm për këtë arsye, por edhe sepse kjo është hera e parë që një institucion shkencor shqiptar në hapësirën shqiptare, kudo qoftë ajo, organizon një konferencë për Organizatën politike "Xhemijet".

Akademik Marenglen Verli, drejtor i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, theksoi rëndësinë e mbajtjes së kësaj konference, duke shtuar se me këtë po nxirret në dritë një kontribut i madh i bartësve të lëvizjes kombëtare, me në krye Ferat Dragën, në një kohë shumë të vështirë për shqiptarët.



Para punimeve të konferencës, u bë promovimi i librave të autorit Skender Asani: "Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore - 1919-1925" dhe "Dokumente per veprimtarinë politike të Xhemijetit". Për këto vepra folën studiuesit Nuridin Ahmeti dhe Sevdail Demiri.

Në konferencën shkencore, kontributet e tyre shkencore i para-

qitën referuesit nga institutet shkencore të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit: Marenglen Verli: "Profili i Ferhat Dragës në dokumentacionin shqiptar dhe serb"; Qerim Lita: "Ferhat bej Draga, prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viteve tridhjeta të shekullit të kaluar"; Jusuf Osmani: "Rezistenca e Xhemijetit kundër zbatimit të kolonizimit dhe të reformës agra-

re në trevat shqiptare"; Hakif Bajrami: "Kongreset e Xhemijetit"; Halim Purellku: "Xhemijeti në zgjedhjet parlamentare në rrethin e Kërçovës (1920 - 1923 - 1925)"; Nebi Dervishi: "Veprimtaria e Qenan Zija Manastirliut"; Zeqirja Idrizi: "Halim bej Deralla, urë lidhëse midis Xhemijetit dhe Komitetit të Kosovës"; Rexhep Shkrijelj: "Sanxhaku dhe Xhemijeti (1917-

1924)"; Naim Halimi: "Xhemijeti në kujtimet e veprimtarit kumanovar, Azem Hoxha"; Ismet Azizi: "Aqif Blyta - figurë kryesore e organizatës Xhemijeti"; Skender Asani: "Burimet historike rreth veprimtarisë së Xhemijetit"; Zeqirja Ibrahim: "Identiteti politik i Xhemijetit"; Jorina Verli: "Procesi i shpronësimit dhe shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia pas shuarjes së Xhemijetit"; Natasha Didenko: "Jeta kulturore dhe politike e myslimanëve sipas Glisha Eelezoviç (1918-1925)"; Nuridin Ahmeti: "Xhemijeti në historiografinë shqiptare"; Alban Dobruna: "Pjesëmarrja e Xhemijetit në zgjedhjet parlamentare të vitit 1923 në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene"; Ardita Hajdari-Buqinca: "Themelimi dhe zhvillimi i veprimtarisë së organizatës Xhemijeti dhe kontributi i vëllezërve Draga"; Murtezan Idrizi: "Disa burime arkivore në lidhje me themelimin dhe veprimtarinë e Xhemijetit"; Beqir Meta pati fjalën e mbylljes së konferencës.

# Logjika e Trump mbi Jeruzalemin dhe pasojat e saj



Nga  
Richard N. HAASS

Kanë kaluar 50 vjet që nga Lufta e Gjashtë Ditëve—konfliktit të qershorit 1967 që, më shumë se çdo ngjarje tjetër, vijon të përkufizojë rrugën pa krye mes Izraelit dhe Palestinës. Pasi luftimet u ndërpre, Izraeli kontroloi Bregun Perëndimor, Gazën dhe Jeruzalemin, përveç Gadishullit të Sinait dhe Lartësive Golan. Pas në atë kohë, bota e pa këtë rezultat ushtarak si të përkohshëm. Rezoluta 242 e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, themeli i asaj që u bë një zgjidhje diplomatike për problemin e palestinezëve pa shtetësi, u miratua pesë muaj pas përfundimit të luftës. Por, siç ndodh shpesh, ajo që filloi si e përkohshme vijoi gjatë. Ky është konteksti në të cilin presidenti Donald Trump së fundmi deklaroi se Shtetet e Bashkuara njohin Jeruzalemin si kryeqytet të Izraelit. Trump deklaroi se SHBA nuk po merrte një pozicion mbi statusin final të Jeruzalemit, përfshirë "kufijtë specifikë të sovranitetit të Izraelit". Ai bëri të qartë se SHBA do të mbështesë një zgjidhje me dy shtete nëse kjo blet dakord me të dyja palët. Dhe ai zgjodhi që të mos e fillojë menjëherë ambasadën e SHBA nga Tel Avivi, edhe pse ai mund të kishte riemëruar thjeshtë atë që sot është konsullata e SHBA në Jeruzalem. Tentativa për të ndryshuar politikën e SHBA ndërkohë që argumentohet se pak gjëra kanë ndryshuar nuk bindi shumë njerëz. Shumica e izraelitëve u kënaqën nga qëndrimi i ri i SHBA-së dhe shumica në botën arabe e më gjerë u zemëruan.

Arsyeja se pse Trump zgjodhi këtë moment për të bërë këtë veprim kjo është një çështje konjunktive. Presidenti sugjeroi se ai thjeshtë po njihje realitetin dhe se dështimet politike të paraardhësve të tij për ta bërë këtë kanë dështuar të sjellin ndonjë lloj përfitimi politik. Kjo është e vërtetë, megjithëse arsyeja se pse diplomacia ka dështuar me kalimin e dekadave nuk ka fare të bëjë me politikën e SHBA-së kundrejt Jeruzalemit dhe ka shumë të bëjë me ndasitë mes izraelitëve dhe palestinezëve dhe distancës së pozicioneve mes të dy palëve. Të tjerë ia kanë atribuar deklaratën e SHBA-së politikës së brendshme amerikane, një konkluzion i mbështetur nga fështimi i njëanshëm në deklaratën e SHBA-së për të kërkuar ndonjë lloj gjëje nga Izraeli në shkëmbim të saj (për shembull, kufizimin e ndërtimit të vendbanimeve) apo të ofrojë ndonjë gjë për Palestinezët (fjala vjen, mbësht-

tjetjen e pretendimeve të tyre për Jeruzalemin). Megjithëse vendimi shkaktoi ca dhunë, kjo ngjan më shumë me një mundësi të humbur se sa me një krizë të krijuar. Ajo që e bëri këtë deklaratë jo vetëm të debatueshme, por potencialisht kundërproduktive është se administrata e Trump ka shpenzuar një pjesë të madhe të vitit të saj të parë në hartimin e një plani për të zgjidhur konfliktin Izrael-Palestinë. Kjo deklaratë mundet ta dobësojë perspektivën sakaq të kufizuar të këtij plani. Se çfarë ka në mendje administrata Trump për t'i dhënë të tjerëve dhe Arabisë Saudite në veçanti, ky është një rol qendror në paqebërje. Baza për këtë këndvështrim është se Arabia Saudite dhe qeveritë e tjera arabe janë më shumë të shqetësuara për kërcënimin e perceptuar nga Irani se sa nga çdo gjë që lidhet me Izraelin. Si rrjedhojë, supozohet se ata janë të gatshëm të vënë mënjanë armiqësinë e tyre të vjetër ndaj Izraelit, një vend që në përgjithësi ka një mendim të përbashkët me ta mbi Iranin.

Progresi në çështjen Izrael-Palestinë mund të krijojë një kontekst politik në botën arabe e cila mund t'i lejojë ata të bëjnë ekzaktësisht këtë gjë. Shpresa në administratën Trump është se sauditët mund të përdorin burimet e tyre financiare për të dety-

ruar palestinezët të bien dakord për të arritur paqen me Izraelin me kushtet që Izraeli është i gatshëm të pranojë. Problemi është se i vetmi plan me të cilin qeveria e Izraelit ka gjasa do të pranojë ofertën e palestinezëve përmban shumë më pak nga çfarë palestinezët kanë kërkuar historikisht. Nëse është kështu, udhëheqësit palestinezë mund të vendosin vetë se është më e mirë të thonë jo se sa të firmosin një plan që me siguri do të zhgënjë shumë nga njerëzit e tyre dhe do t'i lërë ata të dobët përballë Hamasit dhe grupeve të tjera radikale.


Edhe vetë sauditët mund të ngurrojnë të lidhen me një plan që shumë do ta konsiderojnë si shitje. Prioriteti kryesor i udhëheqjes së re saudite nën Princin e Kurorës Mohammed bin Salman është të konsolidojë pushtetin, gjë që princi po e bën këtë duke e lidhur veten me një përpjekje për të luftuar korrupsionin në mbretëri dhe duke ndjekur politikë të jashtme nacionaliste dhe anti-iraniane. Por asnjëra nga këto taktika nuk po ecën tërësisht sipas planit. Përpjekja antikorrupsion, ndonëse deri tani është popullore, rrezikon të njolloset nga përndjekja selektive e shkelësve (gjë që sugjeron se lidhet më shumë me pushtetin se sa me reformën) dhe nga

**Administrata e SHBA-së duket se beson se Arabia Saudite dhe qeveritë tjera arabe janë kaq të shqetësuar me kërcënimin e perceptuar nga Irani, sa do të lënë mënjanë armiqësinë e tyre të vjetër ndaj Izraelit**



raportet mbi stilin e jetesës së vetë princit të kurorës. Dhe përpjekjet anti-iraniane po bëhen të pandashme me atë që po bëhet një luftë jopopullore në Jemen dhe turpërimet diplomatike në Liban dhe Katar. Ndërkohë, planet ambicioze për reformimin e vendit po rezultojnë më të lehta për t'u konceptuar se sa për t'u zbatuar dhe me siguri do të krijojnë pakënaqësi mes elementëve konservatorë. Problemi për Trump dhe Jared Kushner, dhëndri i tij i cili udhëheq politikën e SHBA-së në këtë zonë, është se sauditët ka gjasa do të rezultojnë shumë më pak partner diplomatik nga sa ka shpresuar Shtëpia e Bardhë. Nëse princi i ri i kurorës është i shqetësuar mbi pozicionin politik të brendshëm, ai do të ngurrojë të qëndrojë krahas me një president të Amerikës që shihet aq pranë me Izraelin sa nuk është i gatshëm të plotësojë as kërkesat minimale të Palestinezëve për shtet. E gjitha kjo na sjell ne pas në Jeruzalem. Trump ka argumentuar se njohja e qytetit si kryeqytet i Izraelit është një "hap i vonuar me tepri për të përparuar në procesin e paqes dhe për të punuar drejt marrëveshjes finale." Gjithnjë e më shumë duket se lëvizja e Trump do të ketë ekzaktësisht efektin e kundërt. (reporter.al)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovësia lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 17 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

## Vardari në çerekfinale

Shkup, 17 dhjetor - Skuadra e Vardarit është plasuar në çerekfinalen e Kupës së Maqedonisë në futboll pasi në ndeshjen kthyesë të 1/8 finales ka mundur me rezultatin 0-2 skuadrën e FC Shkupi. Fitoren kampionët aktual të Maqedonisë e arritën në pjesën e dytë me golat e Nikollov dhe Maksimov. Ndeshja u zhvillua në stadiumin në lagjen "Gjorçe Petrov" ku bardhekaltërit ishin nikoqir, ndërsa ndeshja u zhvillua në një atmosferë të mirë të cilën e krijuan grupi i tifozëve "Shvercerat Shkup", të cilët ishin në numër të madh, rreth 1.000. Ndërkohë, pas kësaj fitore Vardari në çerekfinale do të takohet me Shkëndijën. (B.K)

## PAGA, ARSYEJA E LARGIMIT TË RAMADANIT NGA FERONIKELI

"Ata ishin këmbëngulës të vazhdojnë për 1 vit e gjysmë. Unë ju kërkova një pagë më të madhe, por nuk kishin mundësi që të ma plotësojnë andaj erdhi deri tek ndarja", tha Ramadan

Shkup, 17 dhjetor - Skuadra e Feronikeli dhe trajneri shkupjan Zekrija Ramadan, edhe zyrtarisht kanë ndarë rrugët. Pas largimit të papritur, Ramadanin për mediat kosovare respektivisht për "korneri.net" ka folur treguar arsyet e ndarjes mes palëve. Ish trajneri i Trepça '89 dhe FC Shkupi, tregoi se mes tij dhe kryesisë së re të Feronikelit nuk u arrit akordi për kontratën e tij të re. Sipas tij kryesia e re insistoi që Ramadan të

vazhdojë kontratën edhe për 1 vit e gjysmë me kushtet që kishte arritur me ish kryetarin Elshani, mirëpo kjo nuk ishte e pranueshme për Ramadanin.

"Është e vërtetë që po largohem nga Feronikeli, pasi nuk arritëm akordin me kryesin e re. Ata insistuan që unë të vazhdojë kontratën për 1 vit e gjysmë me të njëjtat kushte siç kisha deri tani. Unë ju dhashë një mundësi të mbarojmë kampionatin deri në

fund me kushtet që kisha me kryesinë e kaluar dhe në qershor nëse kanë dëshirë për të vazhduar, të ulemi dhe bisedojmë për kontratë të re. Mirëpo, ata ishin këmbëngulës të vazhdojnë për 1 vit e gjysmë. Unë ju kërkova një pagë më të madhe, por nuk kishin mundësi që të ma plotësojnë andaj erdhi deri tek ndarja", tha Ramadan. Tutje ai uroi trajnerin e ri të Feronikelit, Ismet Munishi dhe kryesinë e re të cilëve iu dëshiron

suksese gjatë stinorit pranverorë. Ndërkohë, fjalët më të mira i adresoi për ish lojtarët e tij. "Futbollistëve dua të ju them se gjithmonë do ti kem në zemër se me të vërtetë janë profesionist të mëdhenj dhe ishte kënaqësi të punojë me këta futbollistë. Shpresoj të kanë shëndet të mirë dhe shumë suksese", përfundoi Ramadan, i cili tani është trajner i lirë dhe ende nuk dihet se cili do të jetë klubi i tij i ardhshëm.



## Tre klube nga Shqipëria pas Mbellas

Shkup, 17 dhjetor - Emanuel Mbella, futbollisti i FC Shkupi është në "orbitën" e Tiranës bënë të ditur gazeta "panorama". Lojtari i krahut të djathtë, i cili mund të luajë më së miri edhe në sulm, pëlqehet prej bardhebluve. Ai shihet si një opsion i mirë, sidomos kur dihet që futbollisti i Tiranës Albi Doka është drejt largimit, pasi shumë shpejt mund të shitet jashtë vendit. Në kësi kushtesh, duke ditur që në dispozicion për këtë krah është vetëm Dorian Kërçiku, duhet edhe një tjetër. I pari do të luajë në mbrojtje, ndërsa i dyti në mesfushë. Stepja e vetme lidhet me moshën, pasi Mbella i ka bërë 25 vjeç dhe bardheblutë aspirojnë që të afrojnë lojtar më të vogël në moshë. Gjithsesi, nuk mund të flitet ende për asgjë konkrete, pasi ish-lojtari i Bylisit, që aktualisht është njëri prej më të mirëve të FC Shkupi, pëlqehet edhe prej Kukësit dhe Flamurtarit.

## "Liria" fiton dy medalje në Bursa

Shkup, 17 dhjetor - Klubi i mundjes "Liria" vazhdon me aktivitet e njëpasnjëshme ndërkombëtare, tani duke qenë pjesë edhe e një turniri të fuqishëm, që u zhvillua në Bursa të Turqisë. Në këtë turnir KM "Liria" udhëtoi me 12-të mundës të cilët janë udhëhequr nga tre trajner, Abdulla Memedi, Ramadan Shabani dhe Sufijan Ismaili. Ndryshe, nga garuesit e

klubit më të suksesshëm shqiptar, dhe në një konkurrencë të fortë, sukses për lëvdatë arritën Muhamed Feruku, i cili fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë deri me 47 kg dhe Besir Alili, që fitoi medaljen e bronzë në kategorinë deri me 42 kg. Derisa, edhe garuesit tjerë regjistruan paraqitje pozitive, por nuk arritën të ngjiten në pedestal.



## Historike, KB "Çair" fiton titullin e dyfishtë

Shkup, 17 dhjetor - Klubi i boksit "Çair" ka fituar titullin e dyfishtë në Ligën e parë dhe atë për junior të Maqedonisë, pasi boksierët e tij në Shtip në kuadër të xhiros së gjashtë dhe të fundit, arritën fitore në Ligën për junior, ndërsa "Pink Panteri" kishte dy fitore dhe një humbje. Derisa titullin në Ligën e parë ata e fituan qysh në xhiron e kaluar, atë të pestë që u mbajt në Shkup. Pas këtij suksesi historik gëzimi ka qenë i madh tek boksierët e KB "Çair" dhe trajnerët e saj. "Po dridhet Shtipi. Klubi i Boksit 'Çair', kampion në dy ligat: ligën e parë dhe ligën për të rinj", ka shkruar menjëherë pas këtij suksese trajneri i klubit, Faton Salihu në profilin e tij në "Facebook".



Pasi triumfit në Kampionatin Ballkanik në Herceg Novi, Osmani akoma i kujton emocionet dhe të njëjtat i rrëfen edhe njëherë për gazetën KOHA, por gjithashtu ai flet edhe për hapat e parë me këtë sport, titullin që edhe më herët e kishte fituar, sukseset tjera dhe pritjet e tija në të ardhmen

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 17 dhjetor - Karateisti i KK "Fati" nga Tetova, Doan Osmani para dhjetë ditësh triumfoi në Kampionatin Ballkanik në kategorinë U21, -75 kg. Osmani ishte "mbret" në këtë eveniment, i cili u mbahej në Herceg Novi të Malit të Zi, ndërsa në luftën finale deri në 75 kg ai mundi malazezin Nikola Maloviç me rezultat 5-3. Ishte kjo një super luftë, të cilën Osmani humbte pjesën e parë të luftës finale, por në pjesën e dytë bëri rikthim duke treguar karakter të fortë dhe me meritë fitoi, sepse ishte maksimalisht i përgatitur. Pasi triumfit në Kampionatin Ballkanik në Herceg Novi, Osmani akoma i kujton emocionet dhe të njëjtat i rrëfen edhe njëherë për gazetën KOHA, por gjithashtu ai flet edhe për hapat e parë me këtë sport, titullin që edhe më herët e kishte fituar, sukseset tjera dhe pritjet e tija në të ardhmen. "Rrugëtimi drejt suksesi të fundit ku u shpalla Kampion Ballkanik ka qenë i pritshëm, pasi puna e pandalshme dhe synimi im dhe i trajnerit Arlind Huseinit, ishte pjesëmarrja në Kampionatin Evropian. Prandaj u nisa drejt këtij rrugëtimi për të arritur fitoren dhe njëkohësisht kualifikimin për në Kampionatin Evropian, i cili do të mbahet në Soçi të Rusisë. Pasi ia arrita qëllimit, jam shumë i lumtur sikurse unë poashtu edhe trajneri Huseini", fillon kështu rrëfimin e tij Osmani. Ndryshe, siç thamë për Doanin triumfi në një eveniment të tillë është i dyti, pasi këto emocione i kishte përjetuar edhe në vitin 2012. "Emocionet e një fituesi të titullit Kampion Ballkanik i kam përjetuar më herët, para pesë viteve (2012). Por, realisht kësaj radhe mund të them që jam më i kënaqur për shkak se jam shpall kampion në një kategori që nuk është aq e lehtë. Pra në atë të U 21, derisa është e veçantë edhe për faktin se jam një nga më të rinjtë në këtë kategori", vazhdoi më tej karateisti nga Gostivari.

#### I INSPIRUAR NGA FILMAT E BRUS LI

Ndryshe, Osmani ndalet dhe tregon për hapat e parë me karatenë të cilat i ka filluar te Klubi i Karatesë "Fati" nga Gostivari. "Hapat e parë me sportin e karatesë i kam filluar në vitin 2004 në Klubin e Karatesë "Fati" nga Gostivari, klub i cili më vonë u shpërngul në Tetovë. Arsyeja se pse vendosa të merrem me karate ka ardhur nga filmat kinez që i shikoja si i ri, respektivisht aktori i ndjerë Brus Li. Si çdo karateist duke i parë filmat e tij, ka bërë që ne kemi filluar të merremi me këtë sport, dha ja sot kjo është bërë realitet", bën të ditur karateisti i KK "Fati". Derisa, gara e parë e Osmanit ka qenë në vitin 2008. "Cara ime e parë ka qenë në vitin 2008 dhe po në këtë garë jam stolitur me medaljen e arit", nënvizoi më tej Osmani.

#### HERCEG NOVI, "QERSHIA MBI TORTË"

Në vazhdim të karrierës së tij Doanit nuk i kanë munguar sukseset dhe medaljet nga turnirët vendore dhe ndërkombëtare. Duke marr parasysh se janë të shumtë, Osmani i thekson disa nga ato.

"Sigurisht se kam shumë suksese në turnirë



"Rrugëtimi drejt suksesi të fundit ku u shpalla Kampion Ballkanik ka qenë i pritshëm, pasi puna e pandalshme dhe synimi im dhe i trajnerit Arlind Huseinit, ishte pjesëmarrja në Kampionatin Evropian. Prandaj u nisa drejt këtij rrugëtimi për të arritur fitoren dhe njëkohësisht kualifikimin për në Kampionatin Evropian, i cili do të mbahet në Soçi të Rusisë



# KARATEISTI QË SYNON PIEDESTALET EVROPIANE DHE BOTËRORE



të vendore dhe ndërkombëtare, por kësaj radhe do të numëroj disa nga ata suksese. Në vitin 2010 dhe 2011 në Kampionatin Ballkanik në Greqi dhe Qipro, fitova vendin e tretë, kurse më pas siç përmenda më lartë, në vitin 2012 u shpalla Kampion Ballkanik në Mal të Zi. Pastaj në Kupën e Botës që u mbajt në Kroaci në vitin

2015 zura vendin e dytë, ndërsa vitin e kaluar në Bosnjë në Kampionatin Ballkanik fitova vendin e tretë dhe jam pjesëmarrës në tre Kampionate Evropiane dhe dy Botërore. Derisa, më në fund si rezultat i këtyre sukseseve, erdh suksesi më i madh, Kampion i Ballkanit në Herceg Novi".

JASIN RADOAN OSMANI, KARATEISTI I KK "FATI" MADANI, ANËTAR I SWIMMING LIRIA"

Unë do të mundohem të ec në hapat e Beratit, por edhe ta kaloj kështu që nuk do të ndalem së punuari bashkë nën udhëheqjen e trajnerit Arlind Huseini. Dua të cek edhe këtë se pikërisht trajneri Arlind Huseini është shkaktar i këtyre rezultateve të mia, por realisht edhe të Beratit



#### NDJEK HAPAT E BERAT JAKUPIT

Ndërkohë, me sukseset që po i arrin, Osmani shpreson të ndjek hapat e Berat Jakupit, karateistit më të mirë nga Maqedonia. Thotë se qëllimi i tij është të ndjek hapat e Beratit, por pranon se dëshiron edhe ta kalojë sa u përket rezultateve që ai i ka arritur. "Qëllimi im është të prek majat e rezultateve më të mira apo të jem në kulmin e më të mirëve, por kjo ndodh vetëm me punë. Unë do të mundohem të ec në hapat e Beratit, por edhe ta kaloj kështu që nuk do të ndalem së punuari bashkë nën udhëheqjen e trajnerit Arlind Huseini. Dua të cek edhe këtë se pikërisht trajneri Arlind Huseini është shkaktar i këtyre rezultateve të mia, por realisht edhe të Beratit. Jam i bindur që me kualitetin që ka trajneri, do t'ia arrij qëllimit dhe në të ardhmen të arrij në piedestalet evropiane për senior", përfundoi Doan Osmani.


## FLET BABAI I YLLIT TË AJAKSIT QË GJENDET NË KOMA

Dëme të përhershme në tru. Njëri prej 20-vjeçarëve më të talentuar të shkollës së Ajaksit, që kish nisur të bënte të flitej për atë, tani po lufton një betejë shumë të vështirë. çdo sekondë me dikë nga familja e tij pranë, nuk e braktisin kurrë shtratin e tij, nuk largohen kurrë. Njëlloj sikur e ndiqnin nga tribuna, tani e mbështesin në një ndeshje që duket se nuk njih fund

Shokët e skuadrës të Ajaks, kur panë të shtrirë në fushë, nuk e kuptuan menjëherë që situata ishte e rëndë, shumë më shumë se një dëmtim muskolor, apo ndonjë kockë e thyer. Kur 20-vjeçari Nouri, u rrëzua pa ndjenja gjatë miqësorës kundër Verder Bremen, në fushë Ajaksi humbte 2-1, dhe të gjithë shkuan të shuanin etjen dhe të freskohen. Një e shtunë dosido, një miqësore për të nisur harmonizimin me trajnerin e ri, për Nouri ishte shfaqja e fundit në karrierën e tij si futbollist. Në fillim vetëm një dy shokë afrohen. Sinkgraven, në anësore nis të shqetësohet, pas tij në bankinë Shone mërmërit diçka, mbase kupton. Në atë pikë, pas një minute, futbollistët e Verder kërkojnë me ngulm mjekët, Huntelaar nis të rrotullohet përqark, ka një shishe në dorë, duket i çmendur. Dikush tjetër vendos duart në kokë, gjermanët përqafohen, vijoje tentativat për ta rijetësuar, për ta vënë në kushte sigurie. Ishte data 24 korrik.

"Ajaks është thëllësisht i hidhëruar të mësojë se Nouri është dia-

# NUK GUXOJ TË FUTEM NË DHOMËN E TIJ!



Abderrahim Nouri

**Të qash çdo ditë nuk ndihmon. Të jesh pozitiv dhe optimist ndihmon. Të lutesh për atë ndihmon. Kur i qëndroj pranë duke i folur, për t'i treguar gjëra të bukura, kjo ndihmon. Tifozët, kundër Fejenordit, shfaqën një foto të tijën. Edhe vetëm ta shihja ishte e rëndë**

agnostikuar me dëme të pariparueshme cerebrale. Mendimet dhe lutjet tona shkojnë për atë dhe për të shtrenjtët e tij në këtë moment kaq të vështirë!", thuhet në komunikatën e Ajaksit.

Dëme të përhershme në tru. Njëri prej 20-vjeçarëve më të talentuar të shkollës së Ajaksit, që kish nisur të bënte të flitej për atë, tani po lufton një betejë shumë të vështirë. çdo

sekondë me dikë nga familja e tij pranë, nuk e braktisin kurrë shtratin e tij, nuk largohen kurrë. Njëlloj sikur e ndiqnin nga tribuna, tani e mbështesin në një ndeshje që duket se nuk njih fund. Vëllai i tij, Abderrahim, ka një mendim të fortë. "Të jesh i nxehur nuk ndihmon. Të jesh i trishtuar nuk ndihmon. Të qash çdo ditë nuk ndihmon. Të jesh pozitiv dhe optimist ndihmon. Të lutesh për

atë ndihmon. Kur i qëndroj pranë duke i folur, për t'i treguar gjëra të bukura, kjo ndihmon", thotë vëllai i Nouri. Ai nuk arrin ende të metabolizojë frakturën që ka tronditur jetën e tyre. "Tifozët, kundër Fejenordit, shfaqën një foto të tijën. Edhe vetëm ta shihja ishte e rëndë", shtoi më tej vëllai. Ndryshe, babai i Nouri shkon në spital gati çdo ditë, me një shpresë të pavenitshme në zemër, që e shtyn përpara, dëshiron të shohë të birin të dalë nga koma. Në një intervistë për "Algemeen Dagblad" rrëfen dhimbjen e tij. "Ishte i pëlqyer dhe i dashur në të gjithë botën. Ja pse është kaq e vështirë të besosh se ishte pikërisht kjo ajo që i ndodh. E kam shumë të vështirë të flas. Me shumë vështirësi gjejmë forcë të futemi në dhomën e tij. Nuk kemi ndryshuar asgjë. Gjithçka është njëlloj si më përpara", thotë babai. Topi ishte larg nga ana tjetër e fushës, kur Nouri u rrëzua në fushë. Për jetën e tij, për familjen e tij, futbollit ka qenë gjithmonë epiqendra, thelbësor. Për këtë arsye i kanë çuar një top në dhomë. "Kur i vendosëm një top ndër duar pamë një buzëqeshje në fytyrën e tij. Jemi të lumtur me të gjithë mbështetjen, por Abdelhak duhet të ketë paqe". Për këtë arsye numri i dhomës së tij mbetet sekret, vendi ku e gjithë

familja e tij qëndron e bashkuar është një kënd shprese dhe lutje private. Te Ajaksi që kur ishte 7 vjeç, "flinte me këpuçet e futbollit të veshura", thotë i vëllai. "Kishte aftësi të jashtëzakonshme", mërmërit Jonk, njëri prej trajnerëve të tij në Akademi, "ishte kreativ, dinte të mahniste publikun. I pata thënë: hap sytë, je Iniesta i ri".

Ekziston një foto që shfaq mirënjohjen e pabesueshme të familjes ndaj tifozerisë. Dhimbje, shpresë, afërsi e thellë. Lutje, vijon, një mërmëritje që vijon, një zë kërkon. Shpresa nuk është venitur kurrë, në zemrat e familjes Nouri. Shtrëngohen përreth talentit të tyre 20-vjeçar, që bota e admiron, por që nuk arriti ta shijojë dot deri në fund, në jetën e tij si bir, vëlla dhe mik. "Ishte një njeri që kishte qenë në koma. Më tha se tani mund t'i japë makinës, të ketë një familje. Marrim shumë forcë nga besimi ynë. Allah na sprovon, por kemi besim tek Ai. Çdo ditë ulem pranë krevatit të tij dhe lexoj nga Kurani. Çdo ditë lutemi dhe mbajmë shpresën".





# VITI 2017, VITI MË I MIRË NË HISTORINË E REALIT

Real Madridi ka mbrojtur titullin e Botës për Klube, duke e mposhtur në finale klubin brazilian Gremio. Në ndeshjen finale që u zhvillua në Abu Dabi, "Mbretërit" shënuan fitore minimale në këtë takim. Ishte Ronaldo ai që i siguroi titullin Realit, duke shënuar një eurogol nga gjuajtja e lirë në minutën e 53

Viti 2017 do të mbahet mend gjatë nga tifozët e Real Madridit dhe jo vetëm. Në këtë vit, si asnjëherë më parë, skuadra e Real Madridit ka arritur të fitojë pesë tituj. Asnjëherë më parë në historinë e klubit, skuadra e Realit nuk ka arritur t'i fitojë pesë trofe brenda një viti kalendarik. Andaj kjo

gjeneratë në krye me trajnerin Zinedin Zidane ka arritur diçka të jashtëzakonshme, për të marrë epitetin e skuadrës më të mirë që ka pasur Realin ndonjëherë. Mbretërit kanë arritur të mposhtin 1:0 në finalen e zhvilluar në Abu Dabi skuadrën braziliane, Gremio. Goli i vetëm i kësaj sfide u shënuar në

pjesën e dytë. Ishte Cristiano Ronaldo që shënoi nga gjuajtja e lirë në minutën e 53'. Ka qenë pikërisht Ronaldo ai i cili është paraqitur në konferencë për shtyp pas ndeshjes finale. "Unë flas në fushë. Mundohem të jap më të mirën dhe ta shijoj futbollin", është përgjigjur Ronaldo në pyetjen rreth formës



Kristiano Ronaldo

**Sigurisht që më lumturon fakti që fitova titullin kampion bote për klube. Realit i Madridit nuk kishte fituar kurrë 5 trofe në një vit. Është një tjetër rekord**

së tij këtë edicion. "Çfarë unë dua të them është se numrat nuk gënjejnë. Dua të vazhdoj të fitoj trofe si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin kolektiv", deklaroi Ronaldo. Në anën tjetër, trajneri i Real Madridit, Zinedin Zidane, ka thënë se skuadra e tij bëri një ndeshje të madhe. Tekniku francez thotë se është i lumtur që skuadra e tij arriti ta fitojë trofeun e pestë brenda këtij viti. "Ne luajtëm një ndeshje të madhe. Ishim plotësisht të fokusuar mirë nga fillimi i ndeshjes. Fitorja është e merituar. Jam shumë i lumtur që fituam trofeun e pestë. Gjithashtu jam shumë i lumtur me këtë ekip", tha Zidane. Ndryshe, edhe pse shënoi golin e fitores, Cristiano Ronaldo nuk u shpall më i miri, por ai fitoi çmimin e dytë, apo "Topin e Argjendtë". Derisa, ky epitet i takoi kroatit Luka Modriç, i cili fitoi "Topin e Artë" në këtë botëror për klube.

## SIPAS TIPOZËVE ZIKALTËR



## Tohir, shkaktari për disfatën e parë të Interit

Interi pësoi të shtunën humbjen e parë sezonale, teksa në "San Siro" u mund 3-1 nga Udineze, humbje që ka shkaktuar mjaft zhurmë. Por, duket se tifozët zikaltër kanë zbuluar shkaktarin e vërtetë të kësaj humbje dhe ai është ish-presidenti Erik Tohir, që ka qenë në tribunën VIP. Ndodh shpesh që sa herë që ish-presidenti vjen

për të parë "live" skuadrën e tij, Interi humbet dhe kaq ka mjaftuar që tifozët zikaltër të reagojnë, duke thënë që Tohir të mos vijë më në stadium. Kjo ishte hera e parë këtë sezon që Tohir ndiqte "live" Interin dhe duket se skuadra i ka bërë një surprizë aspak të këndshme, duke pësuar humbjen e parë sezonale.

## Ançeloti mund të rikthehet te Çelsi

Karlo Ançeloti do të rikthehet te Çelsi. Javën e kaluar ishte "The Sun" që jepte siguri mbi lajmin, ndërsa ditën e djeshme e ka konfirmuar "Daily Record", duke shpjeguar që zyrtarizimi mund të vijë përpara fundit të sezonit. Ish-trajneri i Bajernit të Mynihut, i shkarkuar nga kampionët e Gjermanisë, do marrë vendin e bashkëkombësit Antonio Kontes, i cili vitin e kaluar i drejtoi blutë drejt fitores së titullit, por që, sipas shtypit britanik, është në "krisje" me presidentin Roman Abramoviç. Mes tyre ka pasur takime të ndryshme dhe çështja, nënvizon tabloidi anglez, nuk është më "nëse", por "kur" Ançeloti do rikthehet në Londër, ku ishte larguar nga Abramoviç, pavarësisht fitoreve të Premier Ligës, Superkupës dhe Kupës së Anglisë në vitin e parë. Manjati rus duket të jetë penduar për atë zgjedhje dhe ka parë te ish-mesfushori i Romës dhe Milanit njeriun e



dudur për të kaluar te një menaxhim më i moderuar, krahasuar me atë të Kontes që, sipas mediave britanike, nuk gëzon një raport të mirë me lojtarët, çka është pikërisht një pikë force e Ançelotit.



Viti 2017 ka qenë një vit i mbresëlënës për Cristiano Ronaldo. Ylli portugez si në aspektin individual, ashtu edhe ekipor ka arritur shumë suksese, për ta përmbyllur me Kupën e Botës për Klube, të fituar në Abu Dabi me Real Madridin. Gjatë vitit 2017, 32-vjeçari ka arritur të fitojë La Ligan, Ligën e Kampionëve, Superkupën e Evropës, Superkupën e Spanjës. Kupën e Botës për Klube, të kualifikohet për në Kampionatin Botëror me Portugalinë, "Topin e Artë", Lojtari i Vitit nga FIFA, Lojtari i Vitit nga UEFA, golashënuesi më i mirë në Ligën e Kampionëve e po ashtu të shënoi 53 gola

Mendo  
SIGURI  
PA KUFI.

Mendo



+389 2 3288 800  
[www.uniqa.mk](http://www.uniqa.mk)

SIGURIME  
JETË dhe JO-JETË

Ky ka qenë një nga kushtet kryesore që ka vendosur gati çdo qeveri greke në bisedimet greko-shqiptare. Vendimi është marrë në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave, të mërkurën më datë 13 dhjetor. Duket se negociatat dy ditore më 11-12 nëntor në ishullin e Kretës midis dy ministrave të Jashtëm Nikos Kotzias e Ditmir Bushati nuk kanë qenë aq të pafryshme siç u deklarua zyrtarisht. Takimi i Kretës paska prodhuar një marrëveshje të cilës VKM-ja e 13 dhjetorit vetëm sa ka zbuluar pikën e parë të saj. Kështu, në prag të raundit të dytë të bisedimeve greko-shqiptare, sërish midis Kotzias e Bushatit, që këtë herë do të zhvillohen në Korçë, më 20 janar, pala shqiptare ulet në tryezë si një bisedues vulnetmirë përballë grekëve.

#### VARREZAT NUK KUFIZOHEN NË NUMËR

Aktualisht në vendin tonë janë dy varreza të ushtarëve grekë, një në Këlcyrë dhe një fshatin Bularat të Dropullit. Këto varreza janë ndërtauar gjatë mandatit të dytë të Qeverisë Berisha, që i ka përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave në vitet 2010 e 2012. Në vendimin e tanishëm të Këshillit të Ministrave nuk përcaktohet se sa varreza do ndërtohen dhe vendet ku do ndërtohen ato. Sipas VKM-së së publikuar në faqen zyrtare të Qeverisë del se varrezat nuk kufizohen në numër dha as në vendodhje. Madje fraza në fund të vendimit se: "ngarkohen prefektët e qarqeve ku do të zhvillohen punimet për zbatimin e këtij vendimi", ku flitet në shumës për qarqet haptazi nënkupton që do të jenë disa varreza të shtrira në disa qarqe.

#### INSTITUCIONET

Në VKM përcaktohen institucionet që do të merren me këtë proces që janë; Ministria e Brendshme ka rolin kryesor pasi sipas VKM-së "Ministria e Brendshme në bashkëpunim me bashkitë të cilat do të jenë pjesë e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit të eshtrave, të sigurojë të gjitha lejet për procesin, të përgatitë të gjithë dokumentacionin shoqëruës, si dhe të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur fillimin dhe vazh-



Qeveria Rama ka vendosur që ta hedhë e para hapin drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Greqinë, duke vendosur për ndërtimin e varrezave të reja ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941.

# VARREZA TË REJA PËR USHTARËT GREKË TË RËNË NË SHQIPËRI

dimin e procesit në zbatim të marrëveshjes". Ndërsa, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që do të ndjekin procesin e shpronësimit të trojeve për ndërtimin e vendpërhejeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941. Ministria e Mbrojtjes, në bashkërendim me Ministrinë e Brendshme, do të ndërmarrin të gjitha procedurat ligjore për marrjen në administrim të trojeve për ndërtimin e vendpërhejeve. Po kështu edhe Prefekti i qarkut ku do të zhvillohen punimet e kërkimit edhe në bashkëpunim me bashkitë përkatëse, duhet të ofrojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit në territoret e tyre. Gjithashtu caktohen edhe detaje të tjera teknike, ku përcaktohen institucione të ndryshme mbi mbarëvajtjen e këtij procesi.

#### VENDIMI I PLOTË I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5, të

marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpërhejeve për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.3.2010, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

1. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të ndjekin procesin e shpronësimit të trojeve për ndërtimin e vendpërhejeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, të përcaktuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpërhejeve për ta brenda territo-

rit të Republikës Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.3.2010, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar.

2. Ministria e Mbrojtjes, në bashkërendim me Ministrinë e Brendshme, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për marrjen në administrim të trojeve për ndërtimin e vendpërhejeve, sipas ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

3. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me bashkitë të cilat do të jenë pjesë e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit të eshtrave, të sigurojë të gjitha lejet për procesin, të përgatitë të gjithë dokumentacionin shoqëruës, si dhe të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur fillimin dhe vazhdimin e procesit në zbatim të marrëveshjes.

4. Prefekti i qarkut ku do të zhvillohen punimet e kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit të eshtrave, në bashkëpunim me ba-

shkitë përkatëse, të ofrojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrim-varrimit në territoret e tyre.

5. Me urdhër të Kryeministrit, në zbatim të neneve 2, pika 5, dhe 4, shkronja "a", të marrëveshjes, të përcaktohen ekspertët e palës shqiptare në Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve Shqiptarë dhe Grekë për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtrave, si dhe ekspertët në terren të palës shqiptare.

6. Ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore, të përfaqësuara me ekspertë në Komitetin e Përbashkët në terren të përballojnë shpenzimet për realizimin e detyrave nga këto ekspertë, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të pikës 8, të nenit 1, të marrëveshjes, të organizojë, në bashkëpunim me palën greke, ceremonitë zyrtare në përkujtim të të rënëve në luftë, çdo vit, në datën 28 tetor.

8. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e të gjitha procedurave të zhdoganimit dhe të përjashtimit nga detyrimet doganore sipas ligjit nr.10256, datë 25.3.2010.

9. Vendimi nr.496, datë 29.6.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpërhejeve për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr.10256, datë 25.3.2010", shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe prefektët e qarqeve ku do të zhvillohen punimet për zbatimin e këtij vendimi.

## "Spanja ta njohë Kosovën, nëse dëshiron ta mbajë Katalonjën"

Drejtori i Qendrës për Ballkanin Perëndimor, Rusinë, Turqinë dhe Evropën Lindore, Fredrik Wesslau vlerëson se Spanja duhet ta njohë Kosovën nëse dëshiron ta ruajë Kataloninë



Në një intervistë për gazetën serbe "Politika", Wesslau është përgjigjur negativisht në konstatimin e gazetares se "me të vërtetë do të ishte hipokrite nga ana e Ma-

dridit nëse e lufton separatizmin në Spanjë, kurse e mbështet diku tjetër", përcjell Telegrafi. "Nuk do të ishte ashtu, sepse Katalonia dhe Kosova janë dy raste krejtësisht të

ndryshme. Spanja po dështon për të bërë një ndryshim thelbësor në mes tyre dhe po tregon se nuk është në gjendje të bëjë dallimin midis kërkesave legjitime për vetë-qeverisje nga ajo për separatizëm. Me këtë paqëllimshëm sinjalizon se Katalonia mund të ketë arsye për të kërkuar pavarësinë", tha Wesslau.

Ai tha se "Kosova ka qenë një luftë, dhe Kosovën e kanë njohur mbi 100 shtete, prandaj nuk ka kurrëfarë logjike që Madridi vazhdimisht i fut Kosovën dhe Kataloninë në nja thes, duke dërguar një mesazh, pa vetëdijshëm, se

edhe Barcelona do të ketë të drejtë për t'u shkëputur". "Prandaj mendoj se vendimi racional për Spanjën do të ishte ta njohë Kosovën kurse separatistëve katalanas t'ua bëjë me dije se nuk kanë të drejtë sikurse shqiptarët e Kosovës të kërkojnë shtet sepse situata në Kataloni është krejtësisht e ndryshme, dhe se Madrid ka të drejtë të vazhdojë të qeverisë atje", tha Wesslau. Ai gjithashtu thotë se Qeveria serbe nuk ka asnjë iluzion se do ta kthejë Kosovën, por dëshiron ta "përdorë atë për të marrë më shumë në negociatë me Bashkimin Evropian.

Pas njoftimeve kontradiktore, së fundi u konfirmua zyrtarisht: kurorëzimi mes konservatorëve të ÖVP-së dhe partisë së djathtë FPÖ tani është e punë e kryer. Por kjo nuk është një martesë me dashuri

Në Austri partia konservatore ÖVP dhe e djathta FPÖ kanë rënë dakord për një aleancë qeverisëse. Këtë e komunikuan të dyja partitë pas përfundimit të bisedimeve. Presidenti Alexander Van der Bellen i ftoi kryetarët e partive që të shtunën (16.12) të bisedojnë në Hofburg të Vjenës. Duke iu përmbytur afateve deri në miratimin e forumeve partiake koalicioni pritet të bëjë betimin në fillim të javës. Kryetari i ÖVP-së, 31 vjeçari Sebastian Kurz, kësaj do të jetë kryeministri më i ri në mbarë Europën. Kurz dhe kryetari i partisë FPÖ Heinz-Christian Strache për shtatë javë resht janë konsultuar për krijimin e koalicionit. Shtyllat kryesore të bashkëpunimit ndër të tjera do të jenë reforma tatimore, forcimi i demokracisë direkte dhe një kurs më i ashpër kundër migracionit. Deri tani për shumë pika mungonin detajet. "Ne duam ta forcojmë vendin tonë e të sigurojmë sistemet tona sociale", tha Kurz në një konferencë të përbashkët shtypi me Strache-n. "Në radhë të parë ne



## AUSTRI: GATI KOALICIONI QEVERISËS MES ÖVP DHE FPÖ

duam të kujdesemi për më shumë siguri në vendin tonë, këtë duam ta arrijmë edhe duke luftuar migracionin ilegal." Kurz gjatë krizës së refugjatëve u dëshmuua si një përfaqësues i vijës së fortë: ai kritikoi kulturën gjermane të mirëseardhjes, vendosi një kufi maksimal pranimit për refugjatët në Austri dhe ia doli që të mbyllet itinerari ballkanik, si rrugë tranziti për refugjatët. Zëvendëskancelari i zgjedhur Strache foli për një "porosi të qartë" të votuesve për t'i marrë seriozisht problemet e tyre. Kurz-i kishte kërkuar FPÖ-së kritike ndaj BE-së, që të shprehej për një njohje në parim të kursit pro-evropian. Li-

beralët mund të presin të kenë midis të tjerash postet e ministarve të brendshëm dhe të mbrojtjes. Strache diskutohet të jetë një lloj "Ministri i Mbrojtjes së atdheut" Për Ministrinë e Jashtme FPÖ ka parashikuar ekspertin e pavarur për Lindjen e Mesme Karin Kneissl. Me protesta u shoqërua vendimi për mosaplikimin nga ana e koalicionit si rrjedhojë e presionit të FPÖ-së, të vendimit për ndalimin e pirjes së duahnit në lokale nga maji i vitit 2018. Brenda pak ditësh 330 mijë austriakë kanë nënshkruar online një petition të mbrojtjes ndaj kancerit, që shprehte indinjatë për këtë "hap pas". Nga zgjedhjet parlamen-

tare në tetor ÖVP-ja doli fituese me 31,5% të votave, kurse FPÖ-ja me 26% ishte në vendin e tretë, pas socialdemokratëve të kancelarit të deritanishëm Christian Kraft, që fitoi 26,9% të votave. ÖVP-ja ishte në vitin 2000 në një koalicion me FPÖ-në. Futja atëhere në qeveri e FPÖ-së që drejtohej nga Jörg Haider shkaktoi protesta masive në Evropë dhe BE-ja vendosi madje sanksione. Partia e themeluar në vitet 50-të nga ish-nazistët thaujse fitoi zgjedhjet presidenciale në Austri dhe në kulmin e krizës së refugjatëve madje udhëhiqte sondazhet derisa u kalua nga ÖFP-ja nën udhëheqjen e Kurz-it.



## Pakistan: Nga sulmi vetëvrasës në një kishë janë vrarë 7 vetë

Zyrtarët pakistanezë thonë se së paku 7 vetë janë vrarë dhe afro 30 të tjerë janë plagosur, nga sulmi vetëvrasës në një kishë në qytetin Kueta, në jugperëndim të Pakistanit. Një zyrtar i lartë në provincën e Baloçistanit tha se sulmin e sotëm e kishin kryer dy militantë. Ky zyrtar tha se së pari njëri prej militantëve e aktivizojë jelekun vetëvrasës në trupin e tij në hyrje të kishës, ku ishin afro 400 meshkuj, femra dhe fëmijë, të cilët kishin ardhur për të marrë pjesë në meshën e së dielës, para festës së Krish-tlindjeve. Sulmuesi tjetër nuk arriti ta aktivizojë eksplozivin pasi u qëllua për vdekje nga forcat e sigurisë. Asnjë grup nuk e ka marrë përgjegjësinë e menjëhershme për këtë sulm. Të plagosurit janë dërguar në spitalet kryesore të qytetit Kueta. Të krishterët e përbëjnë 1.6% të popullatës prej 200 milionë banorëve, kryesisht myslimanë, të Pakistanit.

## OKB: Shqyrtohet propozimi i masës kundër njohjes së Jerusalemit

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara po e shqyrton një propozim-rezolutë, me të cilën do të refuzohej vendimi i presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për shpalljen e Jerusalemit për kryeqytet të Izraelit. Me këtë dokument, të përpiluar nga delegacioni i Egjiptit, do shpallej se çfarëdo vendimi për statusin e Jerusalemit nuk do të ketë efekt juridik dhe duhet të tërhiqet. Ky dokument u është dërguar shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbrëmë dhe për të do të mund të votohej javën e ardhshme. Për kalimin e tij kërkohen nëntë vota, por është e mundur se Shtetet e Bashkuara do të paraqesin veto dhe do ta pengojnë miratimin e këtij propozimi.

## Ekvipazhi prej tre astronautëve është nisur për në gjithësi



Ekvipazhi i përbërë nga tre astronautë, me anijen kozmike të prodhimit rus, Soyuz MS-07, është nisur sot herët në mëngjes për në gjithësi nga baza ajrore në Bajkonur të Kazakistanit. Në këtë anije gjenden Scott Tingle, astronaut i agjencisë amerikane të gjithësisë, NASA, Anton Shkaplerov, i agjencisë ruse, Roscosmos, dhe Norishige Nakai nga Agjencia e eksplorimit të hapësirës ajrore të Japonisë. Parashihet që këta astronautë pas dy ditësh do të arrijnë

në Stacionin Ndërkombëtar të Gjithësisë, i cili gjendet në orbitë, në largësi prej 400 kilometrash mbi Tokë. Astronuatët Tingle, Shkaplerov dhe Kanai, u bashkohen astronautëve, Aleksandr Misurkin nga Rusia dhe kozmonautëve amerikanë, Mark Vande Hei dhe Joe Acaba, që në Stacionin Ndërkombëtar të Gjithësisë gjenden prej shtatorit të këtij viti. Para tri ditësh, me një sondë kozmike Soyuz, nga ky stacion arritën në tokë tre astronautë.

## Zbulohet programi sekret amerikan për UFO-t

Ushtria e Shteteve të Bashkuara ka pranuar se në mënyrë sekrete ka zhvilluar hetime për objektet e paidentifikuara fluturuese, të njohura ndryshe me termin UFO, për një periudhë pesëvjeçare. E përditshmja New York Times ka raportuar se programi për hetimin e paraqitjeve të UFO-s ka zgjatur në periudhën 2007-2012, ndërsa ka kushtuar 22 milionë dollarë në vit. Por, gazeta i ka cituar disa burime, që kanë thënë se programi sekret mbetet aktual edhe në ditën e sotme. Pentagoni ka pranuar dje se programi ka përfunduar në "kornizën kohore 2012".

"Ishte vendosur se kanë ekzi-

stuar edhe çështje të tjera të prioritetit të lartë, që meritojnë fonde dhe se ishte në interesin më të mirë të Departamentit të mbrojtjes për të bërë ndryshim", ka thënë një zëdhënës e Pentagonit, e cila megjithatë, nuk ka deklaruar në mënyrë specifike nëse një program i tillë i ngjashëm ekziston ende. "Departamenti i mbrojtjes i merr seriozisht të gjitha kërcënimet dhe kërcënimet potenciale për popullin tonë, për pasurinë tonë dhe për misionin tonë dhe ndërmerr aksion çdo herë kur zhvillohet ndonjë informatë e besueshme", tha kjo zëdhënës e Pentagonit.



NË VITIN E 100-TË TË PUSHTIMIT

## KUDSI PO PËRJETON

## DITËT MË TË VËSHTIRA

Okupimi i vazhdueshëm i Kudsit që nga 9 dhjetori i vitit 1917 ka fituar një dimension të ri me planin i presidentit amerikan Donald Trump për ta njohur atë si "kryeqytetin e Izraelit"

Kudsi, të cilin britanikët e okupuan këtë javë si 100 vjet më parë, në këto ditë po përjeton një nga kohët më të vështira, raporton Anadolu Agency (AA). Okupimi i vazhdueshëm i Kudsit që nga 9 dhjetori i vitit 1917 ka fituar një dimension të ri me planin i presidentit amerikan Donald Trump për ta njohur atë si "kryeqytetin e Izraelit". Që nga njoftimi i Trump për vendimin e Kudsit të mërkurën e kaluar, katër dëshmorë palestinezë janë vrarë dhe 487 palestinezë janë plagosur nga sulmet e forcave izraelite, të cilat gjithashtu kanë arrestuar gjithsej 150 palestinezë në Bregun Perëndimor dhe Kuds Lindor. Kudsi mbase tashmë është i vetmuar dhe i veçuar si kurrë më parë në histori, sepse afër tre milionë palestinezë që jetojnë në Bregun Perëndimor nuk mund të hyjnë në Kuds për shkak të murit që Izraeli ka ndërtuar rreth tyre. Gjithashtu, të ndaluar të hyjnë në Kuds e kanë edhe dy milionë palestinezë që jetojnë nën bllokadë në Rripin e Gazës. Ndërkaq, rreth pesë milionë refugjatë palestinezë të shpërndarë në mbarë botën nga vendet e tyre janë të privuar të kthehen në Kuds, që është ëndrra më e madhe e tyre. Sot numri i palestinezëve që jetojnë në Kuds Lindor të pushtuar nga Izraeli është pak më shumë se 300 mijë. Ata përballen me shumë kërcënime dhe sfida, që nga shkatërrimi i shtëpive të tyre e deri në arrestim. Vendimi i Trumpit ka rritur zemërimin dhe zhgënjimin e njerëzve në qytet.

#### HISTORIA E KOHËVE TË FUNDIT E KUDSIT NGA GJUHA E NJERËZVE TË VJETËR

Nëse jetoni pak në qytet, do të

dëgjoni vazhdimisht përsëritjen që bëjnë të vjetërit të cilët kujtojnë historinë në vitin 1967, kur Izraeli pushtoi Kuds Lindor. "Në kohët e mëparshme, njerëzit nga Gaza sillnin luleshtrydhe për të shitur në Kuds dhe njerëzit nga El Halil sillnin rrush dhe turkmenët portokaj. Kudsi ishte pika e takimit e të gjithë palestinezëve. Kryesisht të premteve mund të vërenit njerëz të ardhur nga mbarë vendi në Portën e Damaskut, e cila është një nga portat kryesore të qytetit të rrethuar me mure. Ndërkohë, tani edhe ata që mund të qëndrojnë këtu distancohen nga të mbledhurit përpara Portës së Damaskut. Madje edhe dyqanet i ulin qepenët e tyre ende pa u errësuar. Ushtarët pushtues presin në çdo cep me duart në këmbëzën e armës", thonë ata. Këto fjali në të vërtetë e shfaqin në mënyrë të qartë situatën ku ndodhet Kudsi. Si filloi procesi që e solli në këtë situatë Kudsin? Për përgjigjen e kësaj pyetjeje duhet vajtur në periudhën e njëqind viteve më parë.

#### PROCESI FILLOI MË 9 DHJETOR 1917

Kudsi, i cili është kibleja e parë e muslimanëve dhe në të cilin ndodhet Xhamia el-Aksa, ku profeti Muhamed (a.s) u nis në udhëtimin e Miraxhit, dhe e cili është shtëpia e vendeve më të shenjta të popullit të krishterë dhe hebrenjve, po përjeton ditë të vështira që nga largimi i sovranitetit osman në vitin 1917. Okupimi i qytetit nga mandati britanik një shekull më parë ka qenë gjithashtu një lloj filimi i mërgimit dhe luftës për palestinezët. Veprimtaria e hebraizimit të Kudsit fitoi vrull pasi Izraeli pushtoi pjesën perëndimore të qytetit në vitin 1948 dhe në vitin 1967 pjesën lindore. Izraeli, i cili u tërhoq nga Gaza në vitin 2005, që nga ajo kohë e deri tani ka shkakuar një krizë njerëzore në rajonet që mban në okupim dhe gjithashtu vazhdon politikën e tij hebraike në Bregun Perëndimor dhe Kuds Lindor të cilin e ka shpallur si kryeqytet duke e aneksuar



drejtperdrejtë. Duke përfutur nga lufta civile në Siri, Izraeli ka njoftuar aneksimin e Lartësirave të Golanit, të cilat i ka patur nën pushtim edhe dy vjet më parë. Arabët palestinezë 5 qershorin e përkujtojnë si "Jevmu'n Nekse" (Dita e Humbjes), kur filloi Lufta Gjashtëditore, që rezultoi me pushtimin e Bregut Perëndimor, Kudsit Lindor, Rripit të Gazës, Gadi-shullit të Sinait dhe Lartësirave të Golanit nga Izraeli në vitin 1967. Kudsi Lindor është pa dyshim vendi ku ndihet në mënyrën më intensive pushtimi izraelit, i cili po vazhdon për saktësisht 50 vjet.

#### QËNDRIMI I KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR

Historia e pushtimit izraelit në Kuds Lindor që vazhdon që prej

Katër nga 420 mijë palestinezë në Kuds Lindor nuk mund të kalojnë në pjesë të tjera të qytetit për shkak të Murit të Ndarjes të ndërtuar në vitin 2003. Lagjet me popullatë intensive si Ebu Dis, Ezerije, Kufr Akab janë ndër zonat që janë ndarë në këtë mënyrë nga qyteti. Muri i Ndarjes gjithashtu bllokoi kalimin e rreth tre milionë palestinezëve në Bregun Perëndimor drejt Kudsit Lindor



gjysmë shekulli është si më poshtë:

- Statusi i Kudsit Lindor është një nga pengesat më të mëdha për zgjidhjen e çështjes palestinezo-izraelite. Në planin e publikuar në vitin 1947 nga Kombet e Bashkuara (UN) për të ndarë territoret historike palestineze në mes të hebrenjve dhe arabëve, parashikohej që Kudsi t'i nënshtrohet një statusi të veçantë dhe të kontrollohej nga komuniteti ndërkombëtar. Arsyeja për këtë status të veçantë që iu dha Kudsit ishte se ai ishte një qytet i shenjtë për tri fetë abrahamike.

- Forcat cioniste pushtuan perëndimin e Kudsit në luftën e vitit 1948. Pasi e mori nën kontroll edhe Kuds Lindor në vitin 1967 që ishte i rrethuar me mure nën kontrollin e Jordanisë, Izraeli duke shkelur të drejtën ndërkombëtare shpalli se në qytet ishin të vlefshme ligjet izraelite. Në këtë mënyrë, Izraeli aneksoi de fakto Kuds Lindor.

- Parlamenti izraelit me një ligj të miratuar në vitin 1980 e deklaroi Kuds si "kryeqytetin e bashkuar" të Izraelit bashkë me pjesët perëndimore e lindore të tij. Kështu, aneksimi i Kudsit Lindor u bë zyrtar. Si përgjigje, Këshilli i Sigurimit i OKB-së (KS-OKB) në vitin 1980 miratoi Rezolutën 478, e cila shfuqizoi deklaratën e Izraelit për shpalljen e Kudsit Lindor kryeqytet duke e aneksuar atë. Komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Kuds Lindor e konsideron të okupuar.

Nga ana tjetër, deri të mërkurën e kaluar, kur Trump deklaroi njohjen e tij si kryeqytet të Izraelit, asnjë vend nuk e njihte Kuds Lindor apo Perëndimor si kryeqytetin e Izraelit. SHBA-të me vendimin e Trumpit u bënë vendi i parë që njohin Kuds si "kryeqytet të Izraelit". Qeveria Trump, e cila është përballur me reagimet e komuniteti ndërkombëtarë, ka injoruar paralajmërimet se ky vendim do ta tërheqë në kaos rajonin dhe do ta bëjë edhe më të pazgjidhshme



Çdo shtëpi e shtuar nga Izraeli në këto vendbanime nënkupton ndryshimin e strukturës demografike në favor të hebrenjve. Autoritetet izraelite në njërën anë zgjerojnë vendbanimet hebreje dhe në anën tjetër pengojnë popullsinë arabe të vendosur në qytet të ndërtojnë ndërtesa të reja



Palestinezëve të cilët kanë leje qëndrimi të përhershme në qytet, me "Kartën e Identitetit të Kudsit" të siguruar nga autoritetet izraelite, gjithashtu mund t'u merren këto të drejta me arsye të ndryshme. Për këtë shkak, mbi 420 mijë palestinezë në Kudsin Lindor jetojnë me frikën e dëbimit në çdo moment nga qyteti i tyre i lindjes



mosmarrëveshjen izraelito-arabe. Të gjitha ambasadat e vendeve që njohin Izraelin ndodhen në Tel Aviv. Sipas vendimit të Trump, SHBA-të do të zhvendosin ambasadën e saj nga Tel Avivi në Kuds. Aneksimi në mënyrë të jashtëligjshme i Kudsit Lindor nga Izraeli në ligjin ndërkombëtar nënkupton shkeljen e parimit se "Forcat pushtuese nuk kanë të drejtë të sundojnë mbi territoret që pushtojnë".

**SHTETAS TË ASNJË VENDI**

Megjithë aneksimin de fakto të Kudsit Lindor nga Izraeli, palestinezët që jetojnë këtu nuk konsiderohen si qytetarë izraelitë dhe nuk gëzojnë përfitimet e shtetësisë. Rreth 420 mijë palestinezë që jetojnë në Kudsin Lindor kanë një leje qëndrimi të përhershme në qytet me "Kartën e Identitetit të Kudsit" të dhënë nga autoritetet izraelite. Palestinezët në fjalë në të njëjtën kohë kanë edhe pasaporta jordaneze, por këto pasaporta nuk kanë as numra të shtetësisë. Për këtë arsye, palestinezët e Kudsit Lindor të cilët nuk konsiderohen plotësisht qytetarë jordanezë, nuk kanë të drejtën të përfitojnë nga shërbimet për punësimin dhe shërbimet shtetërore në Jordani. Qindra mijëra palestinezë në Kudsin Lindor jetojnë "pa shtet" sikur të mbetur në harresë, sepse nuk kanë as nënshtetësi jordaneze, as izraelite dhe as palestineze.

**14 MIJË PALESTINEZË TË DËBUAR NGA KUDSI LINDOR**

Palestinezëve të cilët kanë leje qëndrimi të përhershme në qytet, me "Kartën e Identitetit të Kudsit" të siguruar nga autoritetet izraelite, gjithashtu mund t'u merren këto të drejta me arsye të ndryshme. Për këtë shkak, mbi 420 mijë palestinezë në Kudsin Lindor jetojnë me

frikën e dëbimit në çdo moment nga qyteti i tyre i lindjes. Palestinezët në Kudsin Lindor duhet të plotësojnë një sërë kërkesash të vendosura nga Izraeli në mënyrë që ata të vazhdojnë të jetojnë këtu. Palestinezëve që jetojnë jashtë Kudsit Lindor për një periudhë të caktuar, në një vend të huaj ose në Bregun Perëndimor, u merret e drejta për t'u kthyer në qytetin e tyre, duke u anuluar lejet e tyre të qëndrimit. Ndërkaq, palestinezët që nuk lejohen të ndërtojnë shtëpi në Kudsin Lindor tekta në këtë mënyrë janë të detyruar të largohen nga qyteti, ndërkohë që përcaktohen se banojnë jashtë Kudsit, janë gjithashtu të penguar të kthehen në qytetin e tyre. Përfshirja e një prej anëtarëve të familjes në sulme, që Izraeli i përshkruan si "terror", konsiderohet të jetë shkaktar që e gjithë familja të dëbohet nga Kudsi. Sipas organizatës izraelite B'Tselem për të drejtat e njeriut, mësohet se Izraeli që nga viti 1967 e deri tani i ka anuluar lejet e qëndrimit 14 mijë palestinezëve dhe i ka dëbuar jashtë Kudsit Lindor. Përballë kësaj, Izraeli, nga ana tjetër, inkurajon të gjithë hebrenjtë që të vijnë në Izrael, të marrin nënshtetësinë dhe të vendosen për të banuar kudo që duan, duke përfshirë edhe Kudsin Lindor.

**NË KUDSIN LINDOR JETOJNË ILEGALISHT 200 MIJË KOLONË HEBRENJ**

Projektet ndërtimit të vendbanimeve ilegale hebreje që synojnë forcimin e kontrollit të Izraelit në Kudsin Lindor janë të paligjshme sipas ligjit ndërkombëtar. Sipas

rezolutave të ndryshme që OKB-ja ka miratuar, është e ndaluar që "një forcë pushtuese të mbartë popullsi në territoret e pushtuara". Izraeli, i cili e shpërfill këtë ndalim, që nga viti 1967 ka ndërtuar shumë vendbanime të hebrenjve në Kudsin Lindor. Më shumë se 200 banorë hebre jetojnë sot në këto vendbanime të paligjshme Kudsin Lindor. Në vendbanimet hebreje në Kudsin Lindor që janë të mbrojtura nga policia dhe ushtarët është e ndaluar të hyjnë të tjerë, përveç hebrenjve. Këto vendbanime, disa prej të cilëve ndodhen në mes të lagjeve palestineze, kanë rrethuar qytetin. Planet për ndërtimin e vendbanimeve hebreje, të iniciuara në vitin 1967 nga qeveria izraelite nën drejtimin e Partisë Laboriste të krahut të majtë, kanë vazhduar pa ndërprerje nga të gjitha qeveritë që erdhën më vonë në krye të shtetit. Së fundmi, muajin e kaluar, qeveria izraelite vendosi të ndërtojë 15 mijë shtëpi të reja për kolonët hebrenj në Kudsin Lindor. Sipas televizionit izraelit "Channel 2", qe-

ria izraelite deri tani ka shpenzuar 20 miliardë dollarë për vendbanimet ilegale në Kudsin Lindor dhe në Bregun Perëndimor.

**PALESTINEZËT PENGOHEN TË NDËRTOJNË SHTËPI**

Çdo shtëpi e shtuar nga Izraeli në këto vendbanime nënkupton ndryshimin e strukturës demografike në favor të hebrenjve. Autoritetet izraelite në njërën anë zgjerojnë vendbanimet hebreje dhe në anën tjetër pengojnë popullsinë arabe të vendosur në qytet të ndërtojnë ndërtesa të reja. Në qytetin ku është pothuajse e pamundur që një palestinez të marrë leje nga komuna izraelite për të bërë një shtëpi, bëhet e

se rreth 20 mijë shtëpi që i përkasin palestinezëve janë nën rrezik të prishjes nga forcat izraelite me arsyetimin se ato janë "pa leje". Skuadrat bashkiake herë pas here shkatërrojnë këto shtëpi dhe shpenzimet e shkatërrimit ia ngarkojnë palestinezëve për t'i paguar.

**QYTETI NDAHET NGA PALESTINEZËT ME MURIN E NNDARJES**

Katër nga 420 mijë palestinezë në Kudsin Lindor nuk mund të kalojnë në pjesë të tjera të qytetit për shkak të Murit të Ndarjes të ndërtuar në vitin 2003.

Lagjet me popullatë intensive si Ebu Dis, Ezerije, Kufr Akab janë ndër zonat që janë ndarë në këtë mënyrë nga qyteti. Muri i Ndarjes gjithashtu bllokoi kalimin e rreth tre milionë palestinezëve në Bregun Perëndimor drejt Kudsit Lindor. Askush në Rripin e Gazës me një popullsi prej dy milionë banorësh nuk mund të kalojë as në Bregun Perëndimor, as në Kudsin Lindor.

Kështu, Kudsi Lindor është shkëputur nga brendësia e tij dhe izolohet nga palestinezët.



# PESË ARSYET PSE NDIHEMI TË GJITHË TË URITUR



Ka një sërë arsyesh që mund të ndikojnë tek shëndeti yt duke të shtuar urinë, ndaj është mirë t'i shmangësh ato për të parandaluar pasojat më të rënda për shëndetin tënd

Uria është armiku më i madh për një person që ka nisur të mbajë dietë për të rënë në peshë. Nëse e ke anashkaluar një vakt, është normale të ndihesh e uritur, por nëse ke ngrënë dhe sërish ndjen uri, dije se nuk ke të bësh me diçka të lehtë. Ka një sërë arsyesh që mund të ndikojnë tek shëndeti yt duke të shtuar urinë, ndaj është mirë t'i shmangësh ato për të parandaluar pasojat më të rënda për shëndetin tënd. Më poshtë do të keni mundësi të lexoni pesë nga arsyet më të shpeshta që çojnë në shtimin e ndjesisë së urisë.

**ÇRREGULLIMET E GJUMIT.** Personat që nuk flenë 7-8 orë çdo natë, mund të ndihen gjithë kohës të uritur. Një natë e kaluar me pak orë gjumë mund të rrisë sekretimin e hormonit grelinë, i cili stimulon oreksin dhe të ulë sekretimin e leptinës që e frenon oreksin. Rezultantja e të dy efekteve është shtimi më i lartë i oreksit. Nga ana tjetër, çrregullimet e gjumit mund të çojnë edhe në ndryshime të humorit, alterime të përqendrimit, vështirësi për të qëndruar zgjuar gjatë ditës dhe në shtim të peshës. Nis të bësh 7-8 orë gjumë çdo natë për të rifituar energjitë dhe për të rregulluar nivelet e hormoneve që lidhen me urinë.

**STRESI.** Nivelet e larta të stresit çlirojnë hormonin kortizol nga gjendra mbiveshkore. Ky hormon të shton urinë dhe dëshirën për të marrë ushqime të ëmbla, si dhe ushqime të pasura në yndyrna. Të ngrënë të tepërt nuk të bën ta reduktohet stresin, por të shkakton

një shtim të peshës dhe një sërë problemesh të tjera që lidhen me shëndetin. Simptoma të tjera të lidhura me stresin janë nervozizmi, lodhja, dhimbja e kokës, problemet me gjumin, dhimbjet e stomakut etj. Për ta luftuar stresin, duhet të merreni me ushtrime fizike si dhe të meditonit. Edhe dëgjimi i muzikës mendohet se ndihmon në reduktimin e stresit.

## PROBLEMET ME TIROIDEN.

Uria e tepërt mund të vijë edhe për shkak të hipertiroidizmit. Kur nivelet e hormoneve të tiroides janë të larta, ngjarjet fiziologjike në trup përshejtohen dhe shpenzohet më tepër energji se sa normalisht. Kjo gjë shton urinë për të rimarrë sasitë e humbura të

bëjë më rënie e nivelit të sheqerit në gjak. Një nivel i ulët i glukozës në gjak shton kontraksionet e stomakut, të cilat rezultojnë më pas në shtim të urisë. Nga ana tjetër, ulja e nivelit të glukozës bën që edhe truri "të vuajë" për energji dhe të japë sinjalet e duhura nervore për shtimin e oreksit dhe marrjen e ushqimeve. Simptoma të tjera të hipoglicemisë përfshijnë edhe djersitjen, ankthin, nervozizmin, tharjen e gojës, ndjesi diskomforti etj.

**DIABETI.** Si diabeti mellit tip 1, apo 2 çojnë në shtimin e nevojës për marrje të ushqimit. Normalisht sasia e sheqerit që marrim me ushqimet, shndërrohet në organizëm në një metabolit të vetëm, në glukozë. Glukoza hidhet në gjak për t'u shpërndarë në të gjitha indet e organizmit, në mënyrë që të sigurojë energjinë e nevojshme, në sajë të reaksioneve përkatëse biokimike. Në diabet, glukozja nuk kapet mjaftueshëm nga indet periferike dhe nuk siguron kështu sasinë e nevojshme të energjisë. Kjo gjë mund të çojë në shtim të urisë. Simptoma të tjera të diabetit përfshijnë edhe etjen ekstreme, humbjen e peshës, alterimet e shikimit, lodhjen etj. Mjekimi është farmakologjik me marrjen e insulinave, ose hipoglicemiantëve oralë, gjithmonë nën rekomandimin e një mjeku endokrinolog.

(living)

Publicitet

Në bazë të nenit 19, 20, 21 dhe 24 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës të shkollave të mesme, Kryetari i Komisionit për ekskursione për nxënës në vijim publikon:

### SHPALLJE

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënës të vitit të parë, të dytë dhe të tretë për nxënësit e SHMPK "Dimitrija Çupovski" – Veles

Furnizues SHMPK "Dimitrija Çupovski" – Veles, me seli në Veles, në adresën rr. "Bllago Gjorev" nr. 40, telefoni 043/232-541

Lënda e furnizimit: Ekskursione për nxënës për vitin e parë, të dytë dhe të tretë

Lënda e ofertës është e ndarë me vite.

Të drejtë për të dorëzuar ofertë ka secili subjekt i interesuar juridik i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë turistike.

Ofertuesi duhet të përmbushë kriteret në vijim:

- Të ketë të realizuara së paku tre ekskursione për nxënës dhe aktivitete tjera të lira në tre vitet e fundit.
- Të plotësojë kushtet për transport të grupit të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kushtet e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
- Oferta të mos përmbajë zgjidhje alternative, gjegjësisht të njëjtat të jenë të përcaktuara saktësisht pa mundësi për tu ndryshuar dhe në pajtim me kërkesat e definuara në përkrahimin për shërbimin që është pjesë e ftesës për parashtrimin e ofertave.
- Ofertuesi të ketë në pronësi ose marrëveshje për huazim të së paku tre autobusëve të lartë turistik.

Ofertuesi duhet të sigurojë:

- Polisë për sigurim rrugor dhe shëndetësor për nxënësit që duhet të përfshihet në çmimin e ofruar.
- rrugë, ushqim, akomodim, bileta dhe sigurim për profesorë përgjegjës - kujdestarë të klasave, guidë dhe mjek për udhëtim.

Ofertuesi duhet të dorëzojë garanci bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes në shumë prej 5% të vlerës së marrëveshjes.

Garancia bankare duhet të jetë valide deri në realizimin e tërësishtë të marrëveshjes.

Kriteri për zgjedhje është çmimi më i ulët.

- Çmimi i ofruar duhet të jetë i përcaktuar në mënyrën në vijim për secilin vit veç e veç:
  - Për ekskursionin për nxënësit e vitit të parë duhet të theksohet çmimi i shërbimit me transport dhe bileta të përfshira dhe e njëjta do të paguhet njëherësh pas realizimit të ekskursionit.
  - Për ekskursionin për nxënësit e vitit të dytë duhet të theksohet çmimi i shërbimit me transport, akomodim me darkë dhe mëngjes në Ohër, drekë në Vevčan dhe bileta për diskotekë, dhe i njëjti do të paguhet në tri mujore këste të barabarta duke konsideruar nga muaji i zgjedhjes së ofertuesit më të vulltshëm.
  - Për ekskursionin për nxënësit e vitit të tretë duhet të theksohet çmimi i shërbimit me transport, tri bujtje me darkë dhe mëngjes në hotel, bilete për në Shpellën e Postojnës, Liqenet e Plitvicës, diskotekë dhe lundrim nëpër Danub dhe i njëjti do të paguhet në katër këste mujore të barabarta duke konsideruar nga muaji i zgjedhjes së ofertuesit më të vulltshëm.

### Pjesa 1 - EKSKURSION GJASHTËDITOR PËR NXËNËSIT E VITIT TË III (TRETË)

Koha e realizimit – gjysma e dytë e muajit prill të vitit 2018/gjysma e parë e muajit maj të vitit 2018

Numri i nxënësve 80 +/- 10

Relacioni – Veles-Dubrovnik-Split-Trogir-Liqenet e Plitvicës-Lido di Jesolo-Venecia-Shpella e Postojnës-Vjenë-Budapest-Beograd-Veles

Një qëndrim në Trogir në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes);  
Një qëndrim në Lido di Jesolo në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes), vizitë e organizuar në diskotekë;  
Një qëndrim në Budapest në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes);

Në çmimin e aranzhmanit të përfshihet:

- Udhëtim me autobus në relacionin e dhënë
- Një qëndrim në Trogir në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes) – tryezë suedeze
- Një qëndrim në Lido di Jesolo në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes) - tryezë suedeze
- Një qëndrim në Budapest në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes);
- Vizitë nëpër Dubrovnik, Venecia, Vjenë, Budapest dhe Beograd me guidë profesionale lokale
- Bileta për vendet kulturore-historike
- Sigurim rrugor dhe shëndetësor
- Vizitë të diskotekës
- Organizim dhe udhëheqje të udhëtimit
- Shoqërim të personit mjekësor

### Pjesa 2 - EKSKURSION DYDITOR PËR NXËNËSIT E VITIT TË II (DYTË)

Koha e realizimit – në muajin maj të vitit 2018

Numri i nxënësve 70 +/- 10

Relacioni Veles – Ohër – Veles

Drekë në Vevčan dhe 1 qëndrim në Ohër në hotel minimum me 3\*\*\* në bazë p/p (darkë dhe mëngjes) dhe bileta për diskotekë në Ohër dhe Gjiri eshrave.

### Pjesa 3- EKSKURSION NJËDITOR PËR NXËNËSIT E VITIT I (PARË)

Koha e realizimit – në muajin maj të vitit 2018

Numri i nxënësve 90 +/- 10

Relacioni Veles – Radovish – Strumicë – Veles me vizitë të kompleksit Bella Voda dhe kishës Sv. Trojca në Radovish.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa ofertat dorëzohen në selinë e shkollës personalisht në arkiv ose përmes postës.

Programet e kompletuara do të vendosen dhe mund të merren me mail ose në shkollë.

Kryetar i Komisionit  
Marjana Brndevska Nikolovska

Në bazë të nenit 19, nenit 20 dhe nenit 21 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore të nxënësve të shkollave të mesme 07-9992/3 të 05.06.2014, të sjellë nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe shkencës së RM, Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursionet të SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip, publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

për grumbullimin e ofertave për ekskursione të nxënësve

SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip, rr. Vasil Gllavinov nr. 4, tel. 032/391-459 sstojmenski@yahoo.com

Në bazë të Programit vjetor për ekskursionet shkollore të SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip të miratuar nga Këshilli i prindërve dhe Byroja për zhvillim të arsimit, organizohen ekskursione të llojeve në vijim:

**1. Ekskursione në lidhje me temat dhe përmbajtjet e programeve mësimore (me kohëzgjatje prej një dite):**

- Vizitë të Muzeut të artit bashkëkohor në Shkup. Udhëtim me autobus Shtip-Shkup-Shtip, mjek gjatë kohës së udhëtimit, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë.

### 2. Ekskursion profesional – hulumtues

- Ohër 26.04 – 27.04.2018 (me kohëzgjatje prej dy ditëve, në bazë 1 pansion të plotë (mëngjes, drekë, darkë në hotel me 3\*), guidë të licencuar turistik, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit

### 3. Ekskursion përfundimtar

Në Stamboll – Turqi me kohëzgjatje prej 6 ditë dhe 3 bujtje në bazë gjysmëpansion në hotel me 3\* në Stamboll, periudha prej 13.04 – 18.04.2018, transport me autobus të kualitetit të lartë turistik sipas programit, taksë deri në hotel, bileta për Aja Sofia, Top Kapi, Haremi i Sulltanit, Xhamia e kaltër, Sheshi i Sulltan Ahmetit dhe Hipodromi bizantin, pallati i Ibrahim Pashës, Dollma Bahçe, Saraj Pallati, (biletat të përfshira në çmim) Bajazit – universiteti më i vjetër, Laleli, Aksaraj, Akuaduktin romak, Bejogllu, Pjesën aziatike të Stambollit, lundrim nëpër Bosfor, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek, shoqëruar të licencuar. Të gjitha shërbimet e kërkuara për ekskursionin përfundimtar duhet të përfshihen në çmim.

### 4. Ekskursion sportiv-rekreativ – dimëror

Në Krushevë – Maqedoni, me kohëzgjatje prej 7 ditë në bazë 6 pansione të plota (mëngjes, drekë, darkë) akomodim në hotel me 3\*, udhëtim me autobus Shtip-Krushevë-Shtip, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit, guidë të licencuar turistik.

### 5. Ekskursion sportiv-rekreativ – veror

Në Ohër – Maqedoni, me kohëzgjatje prej 10 ditë në bazë 9 pansione të plota (mëngjes, drekë, darkë) akomodim në hotel me 3\*, udhëtim me autobus Shtip-Ohër-Shtip, sigurim rrugor-shëndetësor pa franshizë, mjek gjatë kohës së qëndrimit, guidë të licencuar.

### Kushtet minimale të cilat duhet të plotësojë ofertuesi janë:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike (dëshmi – DRD formular)
- Të ketë të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione shkollore dhe aktivitete të tjera të lira në 3 vitet e fundit (dëshmi – vërtetim nga shkollat për ekskursione të realizuara dhe aktivitetet tjera të lira)
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat i transportojnë grupet e fëmijëve (dëshmi-licencë)

### Furnizimi NUK është i ndashëm (Ilogaritët çmimi i përgjithshëm i ofertuesit).

- Kriter për ndarje të marrëveshjes për realizim të ekskursionit dhe çmimit më të ulët.
- çmim të përgjithshëm të shërbimit (akomodim, transport dhe ushqim) – për secilin ekskursion
- kushtet për akomodim, meny për ushqim, transport, plus taksë turistik, bileta për ekskursionin përfundimtar;
- në çmim futet edhe sigurimi rrugor dhe shëndetësor i nxënësve pa franshizë, guidat lokal, transferimet në autobusë dhe biletat;
- mënyra e pagesës dhe numri i kësteve;
- guidë, numër të mësimdhënësve dhe mjek
- kushtet e vulltshme të nxënësve të cilët vijnë nga familjet e prekura sociale
- vlerë të garancisë bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes në shumë prej 15% (e dorëzon ofertuesi i zgjedhur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes).
- Ofertat të dorëzohen në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës duke përfshirë edhe ditën e publikimit në shtypin ditor, deri tek Komisioni për grumbullim të ofertave për ekskursione, në arkivin e shkollës ose në adresën e SHMK "Sllavço Stojmenski" – Shtip rr. Vasil Gllavinov nr. 4 Shtip

SHMK Gjmnazi Sllavço Stojmenski Shtip  
Komisioni për grumbullimin e ekskursioneve

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 – teksti i pastuar) ndërsa në lidhje me pëlqimin e marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me nr. ark. 12-13322/2 të datës 05.12.2017, U. D drejtori i SHF pranë IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim – Banja BANSKO publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për plotësimin e vendeve të punës në vijim për vitin shkollor [2017/2018]**

1. Një mësimdhënës të matematikës me 17 orë mësimore në javë për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018. Paga bazë është 17.584 den. Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte me ndërrime. Ndërrimi i parë prej ora 7.00, ndërrimi i dytë prej ora 13.00.

2. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve me 2 orë mësimore në javë për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018. Paga bazë 2.090 den. Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Ndërrimi i parë prej ora 7.00.

**KUSHTET:**

Kandidatët nga pika 1 dhe 2 të kenë të mbaruar arsimin përkatës sipëror në fakultet ose akademi VII-1 ose 240 EKTS.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- të kenë të mbaruar arsimin përkatës
- të jenë shtetas të RM
- të njohin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik,
- të kenë të dhënë provimin profesional për mësimdhënës.

Kandidatët së bashku me lutjen duhet të parashtrorin:  
-Dëshmi për arsimin e mbaruar sipëror (Certifikatë ose diplomë origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)  
-Certifikatë të shtetësisë së RM

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 8 ditëve nga dita e kalimit të afatit për parashtrimin e lutjeve. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. **Të gjitha dokumentet e lartpërmendura me lutjen të parashtrohen deri në: IP Enti për mbrojtje dhe rehabilitim – Banja BANSKO – f. BANSKO pn (personalisht ose me postë).**

IP ENTI PËR MBROJTJE DHE REHABILITIM  
BANJA BANSKO

U. D DREJTOR

Defektolog i diplomuar Stojanka Izova

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), SHF "Goce Dellçev" – Gostivar, publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për plotësimin e vendeve të lira të punës**  
**për kohë të caktuar deri më 31.08.2018**

**Mësimi në gjuhën maqedonase:**

- Një mësimdhënës të informatikës 10 orë dhe inovacione 4 orë (zëvendësim të drejtorit);
- Një mësimdhënës të fizikës 16 orë dhe 6 orë shkenca natyrore;
- Një mësimdhënës të etikës së religjioneve 6 orë dhe 4 orë etikë;
- Një mësimdhënës të aftësive për jetesë 8 orë;

**Mësimi në gjuhën shqipe:**

- Një mësimdhënës të informatikës dhe projekteve të informatikës 15 orë (zëvendësim të zëvendësredjtorit);
- Një mësimdhënës të matematikës 12 orë (zëvendësim të zëvendësredjtorit)
- Një mësimdhënës të etikës 3 orë dhe edukatës qytetare 6 orë;
- Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase 9 orë për nxënësit e bashkësive tjera;
- Një mësimdhënës të mësimit klasor;
- Një mësimdhënës të etikës së religjioneve 6 orë;
- Një mësimdhënës të historisë 4 orë dhe gjeografi 4 orë;
- Një mësimdhënës të arsimin teknik 10 orë (zëvendësim për shkak të aftësisë së ulët të punës);
- Një mësimdhënës të inovacioneve 3 orë;
- Një mësimdhënës të njohjeve të rrethinës 6 orë;

**Kushtet:** Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duke të përmbushin edhe kushtet për mësimdhënës në pajtim me nenin 80 pika 1 të Ligjit për arsim fillor. Orari ditor i punës për mësimdhënësit ndërrimi i parë fillon në ora 7,20, ndërsa përfundon në ora 12,40, ndërrimi i dytë fillon në ora 13,00 ndërsa përfundon në ora 18,25, ndërsa çagesa bazë për mësimdhënës është 20.644 den. Dokumentet e nevojshme nga shpallja: Fletëparaqitje për shpallje, diplomë për arsim të mbaruar dhe certifikatë të shtetësisë (kopje të këtyre dokumenteve të vërtetuar në noter). Dokumentet të dorëzohen në SHF "Goce Dellçev" – Gostivar, rr. "Braka Blazheski" nr. 6, kontakt tel. 042 215 225. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa vendimi për zgjedhje do të silltet në afat prej pesë ditëve pas kalimit të afatit për dorëzimin e dokumenteve.

SHF "Goce Dellçev" – Gostivar  
Drejtor  
Sasho Shareski

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15 - Teksti i pastuar), nenit 80 dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10,18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/015, 98/15, 145/2015 dhe 30/16), Lajmërimit nr. 12-12097/3 të datës 07.12.2017 nga MASH dhe Lajmërimit/Përcjelljes nr. 09-3529/4 të datës 13.12.2017 nga Kryetari i Komunës së Kavadarit, Vendimit nr. 283/1 të datës 14.12.2017, SHFK "Dimkata Angellov – Gaberot" f. Vataša, Kavadar publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar të punës deri më**  
**31.08.2018**

1. Mësimdhënës të gjuhës maqedonase me 20 orë mësimore (40 orë pune) 1 (një) realizues me neto pagesë prej 20.640,00 den.,
2. Mësimdhënës të gjuhës gjermane me 20 orë mësimore (40 orë pune) 1 (një) realizues me neto pagesë prej 20.640,00 den
3. Mësimdhënës të Kulturës klasike e civilizimit evropian me 8 orë mësimore (16 orë pune), 1 (një) realizues me neto pagesë prej 8.256,00,
4. Mësimdhënës të Etikës me 2 orë mësimore (4 orë pune), 1 (një) realizues me neto pagesë prej 2.064,00,
5. Mësimdhënës të mësimit klasor me qëndrim ditor me 20 orë mësimore (40 orë pune) 1 (një) realizues me neto pagesë prej 20.640,00 den., (marrëdhënia e punës për këtë vend pune mund të ndërpritet edhe para këtij afati nëse vjen deri në ndryshim të statusit të drejtorit),
6. Bashkëpunëtor profesional – psikolog, 1 (një) realizues për 40 orë punë me neto pagesë prej 20.640,00 den.

Orari punës së mësimdhënësve është në një ndërrim prej ora 08:00 deri në ora 13:30, dhe përfundon varësisht nga numri i orëve në pajtim me Orarin e orëve për vitin 2017/2018.

Orari i punës me numër rendor 6 është në një ndërrim, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07:00 deri në ora 15:00.

Shuma e neto pagesës bazë të mësimdhënësit praktikant pa provim të dhënë profesional me orar të plotë të punës dhe bashkëpunëtor profesional – praktikant është 16.663,00 den.

Punëtorët kanë të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet nga neni 77 dhe 80 të parapara me Ligjin për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08), edhe atë: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, të kenë arsim të mbaruar përkatës në pajtim me normativin për kuadër mësimor, të njohin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe të kenë të dhënë provimin profesional për mësimdhënës, ndërsa mund të paraqitet edhe personi pa provim të dhënë profesional dhe të lidhë marrëdhënie pune për kohë të caktuar të punës deri në fund të vitit shkollor.

Kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Lutje,
- Certifikatë për arsim të mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),

Shpallja zgjatë 5 ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje. Kontrolli i kandidatëve për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik do të bëhet më datë 25.12.2017 (e hënë) në ora 12 në lokalit e shkollës.

Dokumentet e dorëzuara të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) parashtrohen përmes postës ose personalisht në adresën: SHFK "Dimkata Angellov – Gaberot" rr. "Strasho Pinxhur" nr. 186 f. Vataša, Kavadar. Telefoni për informacione shtesë 043/416-543.

SHFK "Dimkata Angellov – Gaberot", f. Vataša  
UD Drejtor, Marjanço Jankulov

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167 /2015 – teksti i pastuar dhe nr. 27/2016), SHF "Sinisha Stoillov", publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
**Për pranin të mësimdhënësve për kohë të caktuar të punës deri në fund**  
**të vitit shkollor 2017/2018 edhe atë:**

1. Një mësimdhënës të Etikës së religjioneve për kohë të caktuar me orar jo të plotë të punës gjegjësisht me 4 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 4.600,00 denarë.
2. Një mësimdhënës të Gjuhës gjermane për kohë të caktuar me orar jo të plotë të punës gjegjësisht me 16 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 16.000,00 denarë.
3. Një mësimdhënës të Arsimit teknik për kohë të caktuar me orar jo të plotë të punës gjegjësisht me 6 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 6.600,00 denarë.
4. Një mësimdhënës të Etikës për kohë të caktuar me orar jo të plotë të punës gjegjësisht me 2 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 2.800,00 denarë.
5. Një mësimdhënës të edukatës fizike dhe shëndetësore për kohë të caktuar me orar të plotë të punës (zëvendësim për orët e Drejtorit të shkollës, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018), gjegjësisht 20 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 21.000,00 denarë.
6. Një mësimdhënës të mësimit klasor me orar të plotë të punës gjegjësisht 20 orë mësimore dhe neto pagesë në shumë prej 21.000,00 denarë.

Orari i punës së mësimdhënësve është në kuadër të orarit pesëditor të punës prej ditës së hënë deri në ditën e premte, në pajtim me orarin e caktuar dhe numrin e orëve mësimore për secilin lëndë mësimore gjatë javës së punës.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët nga pika 1 deri në pikën 6 të plotësojnë dhe kushtet e posaçme të parapara në nenin 80 të Ligjit për arsim fillor edhe atë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të ketë arsim përkatës;
- Të njoh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të ketë të dhënë provim profesional për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional gjegjësisht edukator;

Në shpallje publike mund të paraqitet edhe personi pa provim të dhënë profesional dhe të lidhë marrëdhënie pune për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpallje duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

1. Lutje
2. CV
3. Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
4. Certifikatë të shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri në arkivin e shkollës ose në adresën SHF "Sinisha Stoillov" – Zërnovcë, rr. "Gjeneral Apostolloski" pn, Personi për kontakt: Zoran Gjorgiev tel. 033-353-065.

Lutjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Këshilli drejtues pranë  
Shkolla fillore "Sinisha Stoillov" – Zërnovcë

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05,106/08, 161/08,114/09,130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 87/13, 113/14, 10/15, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16), dhe nenit 80 dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14,135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17), SHFK "Dedo Ilo Maleshevski" – Berovë publikon:

**SHPALLJE**  
**Për plotësimin e vendeve të punës në vijim për kohë të caktuar të punës më së voni deri më**  
**31.08.2018 në SHFK "Dedo Ilo Maleshevski" – Berovë**

1. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve me orar jo të plotë të punës në SHFK – Berovë dhe periferike (14 orë mësimore), neto pagesë 14.460,00; orët e punës në javë: 28;
  2. Tre mësimdhënës të mësimit klasor me orar të plotë të punës, një në SHFK – Berovë (si zëvendësim të orëve të drejtorit, gjegjësisht deri në kthimin e drejtorit), një në SHP f. Mitrashnicë dhe një në SHP f. Budinarcë, neto pagesë: 20.647,00; orët e punës në javë: 40
  3. Një mësimdhënës të matematikës (13 orë mësimore) dhe fizikës (4 orë mësimore) me orar jo të plotë të punës, neto pagesë: 17.563,00; orët e punës në javë: 34;
  4. Një mësimdhënës të gjuhës maqedonase me orar jo të plotë të punës, (8 orë mësimore), neto pagesë: 8.262,00; orët e punës në javë: 16;
  5. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me orar jo të plotë të punës, (6 orë mësimore), neto pagesë: 6.198,00; orët e punës në javë: 12;
- Orari i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte për mësimdhënësit: prej ora 08:00 deri në ora 14:00 (me orar të plotë të punës) ndërsa për mësimdhënësit me (orar jo të plotë të punës) varësisht nga numri i orëve mësimore.

**KUSHTET:** Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët nën pikat 1, 2, 3, 4, 5 duhet të përmbushin kushtet për mësimdhënës në pajtim me nenin 77 dhe nenin 80 të Ligjit për arsim fillor.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrorin edhe dokumentet në vijim: diplomë – certifikatë për arsim të mbaruar dhe certifikatë të shtetësisë së RM.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas kalimit të afatit.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në adresën: SHFK "Dedo Ilo Maleshevski" – Berovë rr. "Marshall Tito" nr. 66, 2330 Berovë, tel. 033/471-142.

Personi për kontakt: Ana Sivevska.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

SHFK "Dedo Ilo Maleshevski" – Berovë



**Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060**  
**marketing@koha.com.mk**

**Koha**  
E përditshme informative  
[www.koha.mk](http://www.koha.mk)

**URGJENTISHT**  
**Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit**  
**ginekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të**  
**kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221**

“Ëndrra ime më e madhe është të bëhem mjeke. Unë dua t’i shëroj pacientët si unë”, thotë shtatëvjeçarja Shejma



## VOGËLUSHJA SIRIANE QË U VERBUA NË NJË SULM SHPRESON TË SHËROHET



Shtatëvjeçarja Shejma Tafili, e cila humbi shikimin e saj si rezultat i një sulmi me raketa që supozohet të jetë kryer nga forcat e regjimit sirian, ëndërron që të shërohet, raporton Anadolu Agency (AA). “Derisa po vinim në Turqi (nga Halepi) me familjen time, automjeti ynë u sulmua nga raketa të forcave të regjimit. Djali im dhjetëvjeçar e humbi jetën, vajza ime humbi shikimin”, tha nëna e shtatëvjeçares Shejma, Beraim Tafili për AA. Pas

sulmit, Beraim e dërgon vajzën e saj Shejma në provincën juglindore të Turqisë Gaziantep, ku ajo është duke marrë trajtimin që nga “dita e errët” e sulmit. “Ka dy vite që vij në Turqi. Unë jam duke luftuar për trajtimin e vajzës sime”, shprehet Beraim, e cila ende jeton në Siri. Shejma pësoi një dëmtim në kokë dhe u shërua fal trajtimit në Turqi. “Nuk ka asgjë për të bërë për sytë e saj, nuk ka trajtim për të në Turqi. Fëmija im duhet të trajtohet jashtë vendit.

Kemi aplikuar në disa spitale nëpërmjet të afërmeve tanë në SHBA dhe Kanada”, thotë nëna e vogëlushes Shejma. “Vajza ime dëshiron të jetë në gjendje të shohë. Asaj më së shumti i mungon shkollat. Ajo dëshiron të luajë me miqtë e saj”, thekson ajo, duke shtuar se dëshiron ta shohë të vajzën e saj të vrapojë dhe të jetë e lumtur. Shejma mbetet aktive dhe energjike përkundër humbjes së shikimit të saj. “Ëndrra ime më e madhe është

të bëhem mjeke. Unë dua t’i shërojë pacientët si unë”, thotë shtatëvjeçarja Shejma. Shumë sirianë vijnë në Turqi për të marrë trajtim mjekësor. Turqia mirëpret mbi 3.2 milionë refugjatë sirianë, shifër e cila është më e madhe se në çdo vend tjetër në botë. Vendi ka shpenzuar 30 miliardë dollarë nga burimet e veta nacionale për të ndihmuar dhe strehuar refugjatët që nga fillimi i luftës civile siriane, e cila këtë vit është në vitin e shtatë.



## Lakuriqët e natës "pushtojnë" sërish qytezën

Charters Towers është një qytezë shumë e qetë në Australi, me përjashtim të rasteve kur ajo pushtohet nga lakuriqët e natës. Një mizëri prej më shumë se 200 000 dhelprash fluturore, siç quhen nga banorët, kanë mbuluar qytezën e vogël duke shkakuar mjaft pakënaqësi tek rezidentët. Këta të fundit thonë se në të shkuarën në qytezë kanë mbërritur tufa lakuriqësh nate, por kurrë me proporcione të tilla. Me mijëra dollarë janë shpenzuar nga autoritetet më parë, për të larguar dhelprat fluturore nga qyteti, përmes zhurmës së helikopterëve, tymit apo të shtënave, por sa herë që kthehen, ato janë më shumë.

Ekspertët sigurojnë se nuk ka thujasë asnjë rrezik për shëndetin e njerëzve, por e kuptojnë shqetësimin e banorëve që e kanë të vështirë edhe të dalin nga shtëpitë, pasi gjithçka është e mbuluar nga jashtëqitjet e ‘ushtrisë’ së natës. Shumë vende publike si biblioteka apo pishinat janë mbyllur dhe banorët thonë se nuk durojnë dot më lakuriqët nate që shfaqen kur duan. Sipas zoologëve, lakuriqët e natës duhen lënë të qetë që të ushqehen me lulet e eukaliptëve, që janë me bollëk aty dhe pastaj do të ikin, por banorët thonë se duhet gjetur një zgjidhje finale për ta, pasi vizitat nga minjtë me krahë janë bërë vërtetë të bezdisshme.



## 22 vjeçarja që po “digjet për së gjalli”



Një vajze e re është e detyruar të flejë pranë një qeseje akulli, pasi ajo vuan nga një gjendje e tmerrshme në të cilën ndjen se gjuri i saj i majtë po “digjet i gjallë”. Sipas The Independent, 22-vjeçarja Paige Howittu është diagnostikuar me Sindromën e Dhimbjes Lokale Komplekse (CRPS), të cilën mjekët e shpjeguan si një sëmundje, e cila shoqërohet me dhimbje torturose deri në një nivel të bllokimit të gjymtyrëve. Kjo është një gjendje

e pashërueshme, që shpesh e lë Howitt, nga Birminghami i Anglisë, me një ndjesi të vazhdueshme të djegies në gjurin e saj të majtë, ënjtje dhe pagjumësi. Ajo është duke u trajtuar një dhomë të veçantë oksigjeni duke qenë se ajri i pastër ndihmon për të rritur aftësinë e trupit për t’u shëruar. E reja tani shpreson të mblledhë 25,000 mijë paund për të përballuar trajtimet dhe ndërkohë është e detyruar të mbajë pako me akull në

këmbën e saj të majtë.

Sindroma e dhimbjes rajonale komplekse (CRPS), është një sindromë dhimbjeje afatgjatë që shpesh përkeqësohet me kalimin e kohës. Ajo karakterizohet nga dhimbje të forta. Shoqërohet me ndjeshmëri, ënjtje dhe ndryshime në lëkurë. Ajo fillimisht mund të prekë një gjymtyrë dhe pastaj të përhapet në të gjithë trupin; 35% e personave të prekur raportojnë simptoma në gjithë trupin e tyre.

Shkaku i CRPS është i panjohur edhe pse është i lidhur me çrregullimin e sistemit nervor qendror dhe sistemit autonom nervor që rezultojnë në dhimbje të gjymtyrëve të prekura, ose edhe në dëmtime funksionale dhe paaftësi. Trajtimi përfshin medikamente, terapi fizike dhe profesionale, trajtime psikologjike dhe fiziologjike. Megjithatë rezultatet shpesh janë të pakënaqshme, veçanërisht nëse trajtimi vonohet.



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Dita e sotme do jete paksa e ndërlikuar për çiftet. Nuk iu pëlqen aspak kur partneri iu jep urdhra dhe sot kjo do sjelle debate pa fund. Disa mund te marrin edhe vendime te prera. Beqaret do kenë një dite tërësisht ndryshe dhe do e gjejnë personin qe aq shumë kane kërkuar. Ne planin financiar do jeni te detyruar te ulni shpenzimet ne mënyrë qe situata te stabilizohet.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Nuk do jeni te qëndrueshëm ne lidhjen qe keni sot dhe do shihni sa andej këndej për ndonjë person interesant. Kujdes, nëse partneri kuptoni diçka do shkatëroni gjithë atë qe keni ndërtuar deri me sot. Dite delikate kjo edhe për beqaret. Me mire qëndroni edhe sot vetëm. Problemet financiare qe keni pasur do fillojnë te zgjidhen një nga një. Do jeni me te qete ne këtë sektor.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Debatet me partnerin do jete te paketa gjate kësaj dite dhe do flisni me qetësisht me te. Disa mund te bien ne kompromis për diçka dhe te sigurojnë edhe një te ardhme te ndritur se bashku. Beqaret do ndihen te dashuruar pas dikujt, por do e kenë te vështirë t'ia shprehin atij këtë. Nëse doni qe financat te jene te mira, mos shpenzoni pa u menduar.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Do e rigjeni entuziazmin dhe ngrohtësinë qe keni kërkuar gjithë kësaj kohe ne jetën tuaj ne çift dhe do ndiheni te plotësuar me ne fund. Partneri do mundohet ne çdo çast t'ua beje qejfin. Beqaret do ndihmohen nga Saturni dhe nga Marsi. Ata do i ndihmojnë te gjejnë personin e duhur. Ne planin financiar do jete dite me fat dhe përmirësime te ndjeshme.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Dite e mire kjo për te dashuruarit. Do ndani gjithçka me atë qe keni ne krah dhe do kaloni edhe momente entuziazmuere. Ata qe janë me pushime do qëndrojnë me shume kohe pranë njeri-tjetrit. Beqaret do jene ende ne kërkim te princit te kaltër, por mundësitë për ta gjetur sot atë janë te pakta. Ne planin financiar nuk do ketë probleme sepse do e dini mire sa te shpenzoni.



**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Marrëdhënia ne çift do jete shume e qëndrueshme gjate kësaj dite dhe nuk ka për te ndodhur asgjë qe ju nuk e dëshironi. Ata qe ka me shume se dy vite se bashku do mendojnë te krijojnë një familje te re. Beqaret do joshin shume persona dhe njeri do jete ai qe do iu përshtatet me shume. Ne planin financiar do jeni te organizuar dhe nuk priten asnjë problem.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Jeta sentimentale e çifteve do vije duke u përmirësuar gjate kësaj dite. Komunikimi dhe bashkëpunimi me partnerin do shtohet edhe me tepër. Edhe për beqaret priten surpriza shume te këndshme. Përfitoni nga te gjitha ftesat qe do iu bëhen. Ne planin financiar nuk duhet te ndërmerrni rreziqe te mëdha edhe nëse situata do jete tërësisht e qëndrueshme.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Dite mjaft e animuar kjo e sotmja për te dashuruarit. Partneri do mendoje gjate gjithë kohës i t'iu beje te ndiheni te vlerësuar dhe do ua shprehe çdo gjë qe mendoni. Beqaret do kenë një takim te rëndësishëm te cilin nuk duhet ta humbin për asnjë lloj arsyeje. Ekuilibri financiar do jete i garantuar, kështu qe ne këtë plan nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Mos u shqetësoni aspak sot për mbarëvajtjen e jetës suaj ne çift sepse do jene yjet qe do kujdesin për ju. Gjithçka do shkoje me se miri dhe do dashuroheni ne pafundësi. Beqaret do tërhiqen mjaft nga një person qe do takojnë rastësisht ne zyrën e një mikeshë. Njihuni me te. Financat do jene me te mira sesa e kishit parashikuar prandaj ne këtë plan do jeni te qete.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Dite me ulje dhe ngritje kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do debatoni shpesh me partnerin dhe nuk do bini dakord për shume gjera. Beqaret do ngurrojnë te fillojnë një lidhje me personin qe ka kohe qe i josh sepse do kenë frike nga zhgënjimet. Qe financat mos jene problematike duhet te bëni një riorganizim te buxhetit dhe te ulni paksa shpenzimet.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Do diskutoni gjere e gjate sot me partnerin tuaj për te gjitha mosmarrëveshjet qe keni pasur kohet e fundit. Me qetësi dhe mirëkuptim do zgjidhni gjithçka. Nëse jeni ende vetëm, pritet te vijnë mundësi te jashtëzakonshme për te filluar një lidhje pasionante. Tregohuni sa me te hapur! Klima yjore do favorizojë edhe financat. Ato do jene mjaft te qëndrueshme.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Dite plot ngjyra kjo e sotmja për jetën sentimentale te çifteve. Për disa do rizgjohet edhe pasioni i zjarre. E rëndësishme është qe nuk do ketë aspak probleme dhe vështirësi. Beqaret do kenë shume mundësi për njohje te reja, por do hezitojnë. Ne planin financiar do jeni te mbrojtur nga Merkuri. Edhe pse do shpenzoni pak me tepër sesa duhet situata nuk do jete problematike.



<b>Mensur Mamuti</b>	FSHAT NË KASTRAT TE SHQIPERISE	POETI RUMUN, GEORGE	KËNGËTARJA JONË ZARI	PLLAKË GRAMAFONI	NDALFOJJE PYETESE		METRI
AKTORI AMERIKAN NË FOTO					ZHURMË SHAMATE (BISED.)		MOÇALI, LIGATINA
VALËT E RADIOS							DEM
LOJË BIXHOZI ME LETRA							AKTORI ÇELAJ
<b>K</b>						ÇIKLISTI FRËNG, BERNAR	
						VIDEO GAME	
TETOVA			POSEDON (VETA II NJ.) NË RREGULL (HUAJ)			LËNG I HIDHUR I TEMTHIT AJNSHATJINIUMI	
KIMISTI GJERMAN, HAN				GARIM ME LUNDRA URANIUMI			
SPEKTATOR							SHTRESË

ZGJIDHJET: K, NIPAT, NANE, TRUL, JETIM, RISA, VAT, IKRA, PSE, M, BRED PIT, KA, RADIO VALËT, KANASTA, INO, TE, KE, VRER, OTO, REGATË, SHIKUES, KAT.

## Sudoku

*shumë i lehtë*

	9					2		
7	4	2		6		8	3	1
	5			8	6			2
			7		2			
3			4	5			7	
1	6	3		2		7	4	9
	7						1	

*mesatar*

			7		2			
6						8	2	
7					4			
	2			9				4
	5	6	4					
	9				8		6	2
			6			4		1
	3			1				
							5	

Shumë i lehtë: 596813427, 742965831, 831247965, 457186392, 619732584, 328459176, 984671253, 163528749, 275394618. Mesatar: 519782643, 643951827, 782364915, 827196354, 156423789, 394578162, 278635491, 435819276, 961247538.



## Çfarë s'bëjnë për të kaluar kufirin

Policët spanjollë kanë arrestuar një shofer maroken pasi zbuluan një 12-vjeçar afrikan të fshehur në pjesën e përparme të interiorit të veturës së tij. I riu mendohet të jetë nga Guinea, ishte fshehur në pjesën e përparme të veturës, mes telave dhe pajisjeve, dhe u zbulua nga rrahjet e zemrës, pas përdorimit të një detektori special. Një oficer tha se djaloshi ishte në një hapësirë aq të vogël mes motorit dhe ulëses së pasagjerit në mjetin BMW X5. Kur u nxor 12-vjeçari ishte i çorientuar dhe kishte probleme me frymëmarrjen, ai ishte mpirë për shkak të pozicionit që i duhej të mbante, dhe iu dha ndihmë mjekësore në vend. Ngjarja ka ndodhur në pikën kufitare mes Marokut dhe enklavës afrikano-veriore spanjolle të Melillas, në Beni Enzar.

## Apple kërkon punonjës që të bëjnë punën nga shtëpia!

Nëse jeni të dashuruar pas teknologjisë, Apple ofron mundësinë e artë. Mediat e huaja shkruajnë se Apple kërkon punonjës që mund të punojnë nga shtëpia, me orar të plot për pozicionin e punës: AppleCare at Home Advisor. "Nëse e dashuroni mënyrën se si teknologjia ju ndihmon të zgjidhni shumëçka, me siguri do të jeni të shkëlqyer për të ndarë njohurinë tuaj me të tjerët. Këtë do të bëni çdo ditë nga shtëpia", shpjegohet në postimin në website të Apple. Punëtorët do të paguhën edhe për ditët e pushimit, ashtu



sikurse do të kenë zbritje për produktet e Apple. Kompania kërkon që aplikantët të kenë minimumi dy vite eksperiencë në

fushën e suportit teknik, ashtu sikurse të jenë të njohur me zgjidhjen nëpërmjet telefonit, e-mail, chat-it etj.



## Si duket restoranti i parë nudist në Francë?

I vendosur në rrugën "Rue Gravelle", një rrugë e qetë në juglindje të Parisit dhe sapo u përurua restoranti O'naturel, i pari restorant nudist në kryeqytetin francez. Binjakët Mike dhe Staphane Saada braktisën punët e tyre në një shoqëri sigurimesh dhe menduan se do të ishte një ide e mirë ta hapnin këtë restorant në një vend që është destinacioni më i pëlqyer i turizmit. Me mure blu, një ambient minimalist dhe me perde që mbrojnë klientët nga syri i rrugës, O'naturel, ofron pjata klasike të kuzhinës franceze si karavidhe, kërmij dhe mëlçi pate (foie gras). Menuja me tri pjata kushton 57 dollarë. Në hyrje duhet të heqësh rrobat në dhoma zhveshje, bashkë me telefonat celularë për të evituar fotografime të mundshme ndaj klientëve të tjerë. Klientëve iu jepen pantofla, femrat mund të mbajnë këpucët nëse dëshirojnë. Karriqet kanë një copë mbulose që ndrohet pas çdo shërbimi. "Jemi në mes të Parisit dhe po hamë lakuriq, është paksa surrealist", thotë për AFP Yves Leclerc. "Është akoma më mirë se pushimet". O'Naturel është pjesë e një serie restorantesh nudistësh që janë hapur kohët e fundit në Londër, Melburn dhe në Tokio. Në ndryshim nga të tjerët, këtu kamerierët janë të veshur me uniformë. Restoranti është i hapur vetëm për darkën që duhet më parë ta prenotosh. Vëllezërit Saada nënvizojnë se është një punë serioze dhe refuzojnë ata që shkojnë për të "ngacmuar" ndonjë. "Nudizmi nuk do të thotë seksualitet", thotë Mike.

218 BC - Beteja e Trebias: Forcat kartagjenase të Hanibalit mundin forcat e Republikës Romake.

1118 - Alfonso van Aragon okupon Saragosën.

1774 - Perandresha Maria Theresha dëbon hebrenjtë nga Praga, Bohe-mia dhe Moravia.

1878 - Anija franceze Byzantin fundoset në Dardanele, ku vdesin 210 persona.

1917 - Regjimenti sovjetik shpall pavarësinë e Finlandës.

1935 - Edward Benes bëhet kryetar i Çekosllovakisë.

1941 - Trupat japoneze zbarkojnë në Hong Kong.

1945 - Uruguai bëhet anëtare e OKB.

1956 - Flamuri izraelit vendoset në Malin Sinai.

1961 - India përvetëson kolonitë portugeze Goa, Damao dhe Diu

1980 - Vietnami miraton kushtetutën.

1994 - Partia socialiste (ish partia komuniste) fiton zgjedhjet parlamentare në Bullgari.

A e dini se Fan Noli, nga

86 vjet jetë, vetëm pesë i jetoi në Shqipëri. Lindi në Ibrik Tepe të Turqisë, u shkollua në Greqi, më pas në SHBA dhe një pjesë të jetës në Evropë dhe përsëri në SHBA.



Deklarata Universale për të drejtat e njeriut është dokumenti më i përkthyer në botë. Është në dispozicion në 370 gjuhë.



Në Hong Kong gruaja

ka të drejtë ta vrasë burrin nëse ai e tradhton. Ligji qëndron në fuqi vetëm kur ajo arrin ta kryejë krimin me duar. Nëse përdor armë, dënohet me burg!



### MJEKU

Shkon një i sëmurë te mjeku. Sapo hyn brenda, mjeku e pyet:

- Ku ishit para se të vinit këtu?

- Te farmacisti, u përgjigj pacienti. Mjeku përsëri: - Çfarë budallallëku te tha ai?

- Më tha të vija tek ti - u përgjigj pacienti.



Do t'ju thonë se nuk jeni të mirë sa duhet. Mos lejoni t'ju bëjnë për bu-dallenj. Ju jeni shumë më mirë, nga sa duan t'ju bëjnë që të besoni.

(Papa Gjon Pali II)